Te trejta e m'uhjtit e m'ajit, diel, te Vina e arbreshëvet, ju shtrou libri "Vena degli Albanesi nella Calabria del Regno di Napoli" i shkruar nga prof. Giuseppe Giordano.

Flastër: dhashkal Natale Amantea, kreu e Maida, (hora e Vinës), dr. Sigismondo Guzzo, nga bashkëria e horës, kreu nga katundet arbresh e Kalavris e meses, dhashkal Italo Sarro e dhashkal Tommaso Cozzitorto. M'uar pas fjalën dr. Walter Brenner, që shtipi livrin, e dhashkal Popina Lorusso.

Livri flet ka rranja e katundit, nga e para ardhëje e nga e para suvalje, që erdhër me kreu e urshurtorevet, Dimitri Reres, e me të bihjet Gjergji e Vasili.

Dhashkal Sarro po thot se suvalja Reres mën ' jetë shurbis e shtambur, e zgropin edhe ai.

Po ke të thomi se ki andrrin, përsë, njera që ngë gjën gjagjã, ban vet fial e l'jivri e Giordanit, me fjeta të vjetra, gjet se Reres e suvalja e atihj kiljë pë vërtet. Mbishòn shum pirsë arbreshit erdhër te Kalavria e meses, purpara ka atò që erdhër te qaveria e Kusenens, pas që Irene Kastriota ju martua me Pjetrin e Sanseverinevet, kreu nga Bisignano.

Po kitò shurbis tunden e ngë qindrohen e, kur gjehet gjagjã, si bari Giordani, mir vjen.

Dhashkal Cozzitorto mbisòn si dhashkal Zepi e Giordanevet shkruan me tru e me fjeta të vjetra.

Dr. Brenner vu sitë te zãmara e te kujtimet të zotit Giordano.

Ki zot mbilli bashkërinë e thohj se ka shpresë se prapa atihj trimet qenjtin purpara kitò shurbisë e ki livrë ndihin të zgjonjë gluhen e tonë, gluhen e Vinës. Ngë gluha e Vinës desë, desë edhe rranja e katundit.

Mua më nget vet të haristisinja, si bir e Vinës, dhashkaljin Giordano, l'jinar e katundit.

Il 3 Maggio, domenica, a Vena degli Albanesi, è stato presentato il libro "Vena degli Albanesi nella Calabria del Regno di Napoli", scritto dal prof. Giuseppe Giordano. Hanno parlato: il prof. Natale Amantea, sindaco di Maida (capoluogo di Vena), il dr. Sigismondo Guzzo, assessore delle minoranze linguistiche, il prof. Italo Sarro, il prof. Tommaso Cozzitorto. Hanno preso poi la parola il dott. Walter Brenner, che ha stampato il libro e la insegnante Ippolita Lorusso.

Il libro parla delle origini del paese, della prima venuta e della prima ondata di albanesi che vennero con il comandante dei soldati, Demetrio Reres, e con i figli Giorgio e Basilio.

Il dr. Sarro ha affermato che l'ondata Reres può essere anche cosa non vera e che sta approfondendo anche lui.

Però dobbiamo dire che questi fa solo ipotesi, in quanto, fino a quando non trova qualcosa, fa solo parole, e il libro del Giordano, con documenti antichi, ha trovato che Reres e la sua ondata sono una realtà. Ha molto peso il perché gli albanesi vennero nella Calabria di mezzo, prima di quelli che vennero nella provincia di Cosenza, dopo che Irene Castriota si sposò con Pietro Sanseverino, principe di Bisignano. Ma questa questione è in movimento e non si ferma e, quando si trova qualcosa, come ha fatto Giordano, ben venga.

Il dott. Cozzitorto precisava come il prof. Giordano aveva scritto con raziocinio e sulla base di antichi documenti.

Il dr. Brenner ha posto l'accento sul cuore e sul pensiero del Giordano. (ricordo-sentimento e memoria)

Questo autore (il prof. Giordano) ha chiuso la riunione ed ha affermato che spera che, dopo di lui, i giovani portino avanti questi lavori e che questo libro aiuti a risvegliare la nostra lingua, la lingua di Vena. Se la lingua di Vena muore, muore anche l'origine (l'identità) del paese.

A me compete solo di ringraziare, come figlio di Vena, il prof. Giordano, faro del paese.

Kultimet e Mario Caruso i vogul

Francesco Marchianò
ka Spixana (Cs)

Lufta është dëmi më madh e mizor për gjithë gjindjat, edhe më shumë kur nget kriaturët (femijtë). "Racconti d'infanzia - Scene di vita di un paese nel 1940-45" është një libër kultimesh i Marit Caruso, aktor arbëresh ka Spixana, që rrëfien jetën e tij kur ish i vogul ndë mes të mjera, pra me nder, nën siut i mir i s'jëmës Mafanhika. Mario rrëfien kur Spixanë ishën suldet italianë që buftohëshin të mira me gjithë e i jipjen të ngrëne kriaturvet. Kur erdh 8 shtatori 1943, mbrënda te katundi shkojnë tedeskrat e natnet ecjën udhet e katundit sa të ngapojnë ushtarë italianë e Ebrera që kishën shpëtuar ka kampi i Ferramontit.

Mari, si ish i vogul, u gjënd shumë herë me jetën e kamaruar; po ish keq i zgjuar e kjo e shpëtoi dica herë.

Me këta rrëfime Mari Caruso na thot si ish katundi te vitet e fundit të fashizmit, të luftës; na rrëfien si gjëlljën Spixanjotët tek ata vite të ngurta e të forta për gjithë. Kur që "Dita e Kujtesës", nxënësit e skollës vunë në gjuhën arbërishte të Spixanës një rrëfim që pat një sukses i madh.

Vallet Çifit

Veronica Rovitti
ka Çifti (Cs)

Dí ditë dhopu Pashkët, Çifit, si nga vit, u bën vallet. Simbjete Çifti organixarti di Valle të katundit; e para ish e bënur ka më t'vikrat c'kan mbi dhjetë vjet, e e dijta c'ish e bënur ka më t'mbëdhentj. Qaca, edhe ndëse ca her bijen pika shiu, ish plot me kënga, me kamizolla e coha llambadhore. Gjith kta elemende bastuan t'i jipjen ksaj ditje diallin niçsar per t'mblith grupet e forestjervet që na erthin ka llargu. Vallet t'huaja cë mbitarti Çifti klenë: Fontana vecchia (Casaldumi), I canti del Fasano (Fasano), Irizema (Bova Marina), Katundi Jonë (S.Marzano), Yllazët të Regjenda (Ururi), Të Bukurit (Lungro), Shqiponjat (S.Sofia), Ullanja (S.Benedetto U.), Bashkia (Acquaformosa), San Martino di Finita, Mongrassano, Barile. Po nëng bastuan të vijen gjith grupet t'shkruar këtu pirsipir, e augurarmi se ndër vitrat ç'vijen mund jenë gjith bashkë te qaca jonë.

VALLE E LLIÇJUNA

Frasnitë/Purçill - Simbjet që një Pashkë e liksht, domethënë se *Vallet* nënqenë organixartur ka Kumuna, si nga vit, e dualltin jashtë si do Krishti; *Ushtria e Skanderbekut, Ata me kutullen e Ata që nxijen*, pra, ...më mirë se trimi qetë! Nani ç'u nga virtet fundi, Aministracjuna e re ka t'marrë vet njëudhë, atë që predhikomi ka një jetë: Pashktë e Frasnites-Purçillit kanë i vëhen ndër duart një Komitati të ngushtë - të drejtuar ka Sindku - që mirret gjith vitin vet me këtë problem.

Simbjet qenë Llicjunat. Ato "Europee" i vinxhoh Berlusconi (Pdl), ato "Provinciale" i vinxhoh Oliverio (Pd). Ato "Aministrative" i vinxhoh arkitekti Frangjisk Pellicano, që që sindak edhe njeter herë (1999-2004): atij i uromi t'shurbenj për të miren e di katundevet. Purçilli pat vicesindkun, prof. Mikell Greco, dhe asesurin e Bilançit, Mimmo Mundo. Frasnjotë janë Sindku; asesorja e Kultures, prësidhla Ngjiska Camodeca; e asesorla e Turizmit, Karollina Sancineto. Ka Sindku presmi shumë, pse shumë mund japë; e i thomi t'verë ture ecur Katanxar, Rromë e Bruksell, më shpejt se ndë skollët o t'rrirë te Kumuna. Ka Vicesindku, purçilot, presmi t'i japë Purçillit nderen ç'buar ka mot.

E nani japmi gjë nutixje mbi senatorin Vasil Giordano. Ndër **5 te fjavarit 2009**, bashkë me senatorët Di Girolamo e De Gregorio (Pdl), firmarti projekt-ligjin "Dispozicjone per ruajtjen e jetes" e senatorit E.Caselli, që hin tev avlaqi i debatit mbi dhjaten biologjike.

Ndër **24 te fjavarit '09**, tek Auditoriumi i Udhes Conciliazione, Rromë, u presëndar

zyrtarisht "Fondazione Italiani nel Mondo", e krijuar nga sen. Pdl De Gregorio (presdhent), e ka senatorët Giordano, Di Girolamo, Caselli, e ka on. Berardi. Te Shfaqja, ku s'bastoj t'mirë pjesë presdhenti Berlusconi, qenë edhe ministret on. La Russa e Frattini. Fondacjona, ndër **21 të marsit**, që pra e presëndartur edhe në Buenos Aires (Argentina). Kjo Fondacjonë, ndër ditët e terremotit t'Abrucit, me 6 autotrene, dirgoj: 3 ambullanca, 3 jatronj kirurgja, 11 infermjerë e 400.000 butile ujë.

Ndër **26 te fjavarit '09**, senatori Vasil Giordano, hapi në Filadelfia (Usa), bashkë me on.Berardi (të atij vendi), një Rreth politik Pdl: është i dijti, pas atij të Montrealit (Canada).

Ndër **19 te majit '09**, u bë xhemellaxhi Lombardia-Québec: rregjist që senatori Vasil Giordano, që hapi e qelli perpara, për një vit, dialogun Formigoni-Charest.

Kush do t'vehët në kontakt me senatorin Vasil (Basilio) Giordano, ki është ndirici i ufçit tij: piazza Madama, 1 - 00186 Roma.

tel. 06-67063174 / Faks 06-67065087

e-mail: segreteria@basiliogiordano.com

www.basiliogiordano.com

"RINASHITA" BASHKISË

Bëra një poezi me k'gjë ju thom

se për kujtim juve qindron.

Te ki dimilë e i nëndith vit

u di "Rinashita" e kësaj Frasnitë.

Ki arkitekti Pellikan

bëri një të mirez pënxatë:

me Mikellin e zonjen Ngjiskë

bën një t'zgjedhurez llistë:

Karollinen e pënxuan

e mjesnatë vanë e m'e zgjuan.

Thanë:"Karolli, më e vogla je, po nd'mes t'neve na bën hje".

I rujte simbullit e the:

"Ë Rinashit? Ëmer t'bukur ç'ke!"

Te kjo Qishë me kùpull mbanë

qenë kllogjrit me Arbreshzit tanë:

atjë di shëjtrat i nderuan

e pra ndër zëmrat na qindruan:

shkuan më se pesqind vjet

po na nga vit i mbami mend

e atire i bëmi t'madhe festë (...)

Ti kur u vure e predhikove

pjeqzit shumë po i nderove:

ata duart të batuan,

than: "Gjith vërteta kto ç'je thua".

Shën Pjetri e Pali për ju pënxoj

e ajo "kùpull" më vinxhoh.

Ju at Qishë s'kin e harroni,

sa më njenjë kin e dertoni.

Ata di shëjtra mozik kin bëni

e prapa autarit kin i vëni:

se ata për ju pënxuan

dhjaj se si e merituat.

At derë Bashkije ju e haptin

e qiçet ju i kunxënjartin.

Gëzim i math kur the: "Vinxhùam!

E ëmri im që ai më i shkruar!".

Shumë urime na ju bëmi,

kta di katunde kin dritsoni!

Shurbise t'mira ju kin bëni

e me ne shumë mot kin rriini.

Urime atire ç'ju votartin

se qen t'urt e nëng zbalartin.

Lucia Amato, ka Purçilli (Cs)

Këpucët të rea

Sa shërbëti! Sa djersë! Sa lotë!

E gjithë këto halle për një parë këpucë të rea!

Prita javë e javë e, pas mue, mëma ime buri t'i më bënë një parë këpucë të rea.

Kur mjeshtri më pruri këpucët, të djelë it'i prapa ndë derë e u nëng shihënja kohën t'arrë! Matënja motin ashtu si barëtori mat barët pë sëmuret.

Si arruri të djelë, menatët u ngrehta kur ite bëj faraks, u lata këmbë e krie, u vësja, vura shtrunfët e, pas, këpucët.

Me ato këpucë ndë këmbë ndihëshnja i bugatë shumë.

Vajta ndë klishë, pava Meshën e, si dolla, ngata gjithë katundëni. Si nganja, më dukëshi se kush më vrij lej sitë, e u harëshshnja, harëshshnja një det.

Kur nxirinja këpucët ka këmbët, i shinja me një pecë e i vënja nde një anë mbrënda sënduq.

Me ato këpucë kam shkur një det mot, përçë i vënja vet...të djelët e ditët e feshtëve.

Pas kaq vjet ato këpucë i mbanj edhe vjerrë ndë anë e shtëpisë pë prapa, përçë ato këpucë pë mua ishënë si ar.

Quanto lavoro! Quanto sudore! Quante lacrime! E tutte queste sofferenze per un paio di scarpe nuove! Aspettai settimane e, dopo mesi, mia madre mi fece fare un paio di scarpe nuove. Quando il ciabattino mi portò le scarpe, la domenica era alle porte ed io non vedevo l'ora che arrivasse! Misuravo il tempo così come il farmacista misura le medicine per gli ammalati. Come arrivò la domenica, la mattina mi alzai mentre albeggiava, mi lavai dalla testa ai piedi, mi vestii, misi le calze e, dopo, le scarpe. Con quella scarpe ai piedi mi sentivo ricchissimo. Andai in Chiesa, ascoltai Messa e, una volta uscito, camminai per tutto il paese. Come camminavo, mi sembrava che tutti mi ammirassero e io gioivo, gioivo immensamente. Quando toglievo le scarpe dai piedi, le pulivo con uno straccio e le mettevo in un angolo dentro la cassapanca. Con quelle scarpe ho camminato tantissimo tempo, perché le mettevo soltanto...le domeniche e i giorni festivi. Dopo tanti anni, quelle scarpe le conservo ancora: sono appese in un angolo della stanza retrostante (la casa), perché quelle scarpe per me erano oro.

Giuseppe Gallo
nga Shën Marcani (Ta)

Poezi e një anonimi brazilian, e pjerrë arbërisht

Lajm i butësisë

(pruar arbërisht) **Carmine Stamile**

ka Shën Japku (Cs)

Ëndra se ngjisënja
ndë prajën e detit me t'Ënë Zot
e shihënja ditët të jetës sime e shkuar.
E për nganjë ditë e shkuar
dukshin mbi shur di pedhata:
timet e ato të t'Inë Zoti.
Po ndë ca pjesa pe një pedhatë e vetme,
sidomos ndë ditët
më të kequra të jetës time.
Sa pe ashtu, thash: "Oj Zot,
u zgjodha të rronja me tij

e ti më kinje taksur
se kinje mbetur ngaherë me mua.
Pse më lëreve të vetëm
sidomos ndë ditët më të kequra?".
E ai m'u përgjegj:
"Biri im, ti e di se u të dua mirë
e nëng të lë mosnjëherë;
ditët ndë të cilat
është vetëm një pedhatë mbi shur
janë sidomos ato ditë

MESSAGGIO DI TENEREZZA - Ho sognato che camminavo / in riva al mare con il Signore / e rivedevo sullo schermo del cielo tutti i giorni della mia vita passata. E per ogni giorno trascorso / apparivano sulla sabbia due orme / : le mie e quelle del Signore. / Ma in alcuni tratti ho visto una solaorma, / proprio nei giorni / più difficili della mia vita. /Allora ho detto: "Signore, / io ho scelto di vivere con te / e tu mi avevi promesso / che saresti stato sempre con me./ Perché mi hai lasciato solo / proprio nei momenti più difficili?" / E lui mi ha risposto:/ "Figlio, tu lo sai che io ti amo / e non ti ho abbandonato mai :/ i giorni nei quali / c'è soltanto un'orma sulla sabbia / sono proprio quelli. (Anonimo brasiliano)

Vjershe malli

(mbjodhi) **Daniela Moccia**

nga Shën Benedhiti (Cs)

Gjithë sonde e këjo natë
njera sa na bënë ditë
shkon kjo e thot vemë
se jot' ëmë rri e të pret,
rri e të pret ndë vatëri
ture qarë me lotë ndë si,
ture gjegjur këtë fjalë
zëmra ime bëhet dí,
jamuri i mëmës çë më sërret
jamuri im çë mua më pret.
Lulja kur është e bukur
del mbi gjëmba t'jer e dukur,
gjajpri im me buzën e shqerr
mua m'e nxjer një mall i thell,
kurçë fjo e kur u shërbenj
sembre tij u të penxonj
mos me dorë u nëng të rrëmbenj
njize des e nëng rronj.
Vjen e dielza menat


merr krëharin me dorë
m' i zgjidhën leshtë e gjata
m'i armán si një kërorë.
Kozëz pirez e sa xhentille u rrite,
aposta trim si jot sperdianu vete

Shkova nga një gjitoni e ngë m'u duke ti,
m'u dukë dialli çë shtroj mbi dhe

Jam e partinj: vete surdat,
vajzën e time jam e lë mbi shtratë
Amë unazën t'e mbanj ndë gjishtë
të rikordanj jamurin tek u do është

Kopile e bukur e lart si një ndinë
se kur të qasem ndanë hjenë m'e mbanë

Vajta ndë mal e më ngallosi një ferr
ki është llu sinju se ka të të marr



Tutta la sera e questa nottata / fino a quando farà giorno / passa questa e dice andiamo / perché tua madre ti sta aspettando, / ti sta aspettando al focolare / piangendo con le lacrime agli occhi; / ascoltando questa parola / il mio cuore si spezza:/ L'amore di mamma che mi chiama, / l'amore che mi attende;/ il fiore quando è bello / esce sulle spine per essere visto;/ il mio serpente con il muso strappato / mi toglie un desiderio profondo. / Quando dormo e quando lavoro / sempre te io penso,/ se con le mani non ti afferro presto / muoio presto e non vivo./ Viene la domenica mattina / prende il pettine con la mano / mi slega i capelli lunghi / e me li acconcia come una corona

Chicco di limone e quanto gentile sei cresciuta,/ per questa ragione un giovane come il tuo va sciogliendosi (perdendosi)

Sono passato da un vicinato e non mi sei sembrata tu,/ mi è sembrato il sole che risplendeva sulla terra /

Sto partendo: vado a fare il soldato,/ la mia ragazza me la lascio sul letto / Dammi l'anello per tenerlo al dito / per ricordare l'amore ovunque sia

Fanciulla bella ed alta come un albero della cuccagna / quando mi avvicino a te mi fai ombra

Sono andata in montagna e mi si è impigliato un rovo: / questo è il segno che devo sposarti /

Kënkat e martesës

(mbjtho) **Agostino Giordano**

ka Purçilli (Cs)

(nusja lan liveret e saj)

I.
Dit e bardh shkepti ka mali *,
dielli brinjajvet m'u shtu
e dritsoi katundthin:
prana qet e lé më hiri
te ku fjëj vasha e dëlir
e ndër ëndrra fjturonej,
se m'i qasej dita e lumt
çë vej nuse ajo zónj.
Dielli faqzen m'i shkelqei
e m'i kputi gjumthin,
gjumthin e ëndrren,
e m'e zgjoi vashëzën.
U ngre vasha e m'u stolis,
muar shqëndezit e holla
e me shoqezit u nis
pjot harë drej lumit ' math.
Udhes vej lumja kopile
bashk me shoqezit hajdhjare,
si një e bëshëm trëndafile
e rrethuar me rrothostane.
Tek po shkojen vashazit,
ture knduar ndëpër lulet,
jeta qeshnej e lulzonej,
zëjen valle zarazit.
Kur te lumi prana errún,
atjë hiri vasha nd'új.
Muar kopanin e, tue qár,
shqëndezit zu e m'i lan.
Lajen vashazit e kndojen
bashk me zarazit e malit
e me dreqezit e lumit,
tek me këmbëzít m'i shtipnjen
shqëndezit ajo kopile.

Bie kopani, bie pa prër
mbi liverezet e bardha:
si kopani, bie edhe zëmra
mbrënda gjirit e kopiles,
tek e kuqe e tue shërtuar
valles pas thëllëzavet
trut i ndën si noerí.

* *Kjo këngë (e zakonme) s'gjëndet as tek Raspoditë e mbjedhura ka De Rada as ndër ato të G.Schirò-it.*

(gafia e petës)

II.
Se ti vashëza hajdhjare *
me mbë shpi tët ëm e t'tat,
sa hajdhjare edhe dëlir
çë më ngjeshen ata brum,
ngjeshen fort e ngure shum,
bën kuleçe e m'i dërigo
gjithë gjirivet mbë shpi,
gjithë gjitonvet mbë derën:
të t'mburonj buka ndër duar,
të të shtohen dit't e mira,
të të zbardhet ajo jet
pjot me drit e me harë,
si e bardhez je ti vet.

* *E rrëfjejtí Sepmaria Makanit/Ferrari Epifanio, ka Frasnita, ditën 20-8-1973. Kjo këngë (e zakonme) gjëndet edhe tek "Rapsodie Nazionali" të J.De Radës, (libro I, pag.22, Canto del lievito); i qaset tekstit të De Radës vet për të parët 5 vjershe (ndrison vet ndër format gadhjare/hajdhjare,*

ngjeshen-ngjeshje/gjeshen-gjeshje); pëstaj ndërton tërësisht: teksti deradjan ngjatat njetër 6 vjershe, kurse teksti purçilot-frasnjot ngjatat njetër 10)

(kumbaret, naten e vijilljes, i këndojen nuses)

III.
Moj ti luleza vjoll *,
priparare at kamizoll,
se ti menat ka t'vësh kuror:
menat dihet një dit me drit
e vjen e t'merr ai malli it
e më t'qellen nd'at Frasnit.
Lë ti vixezit çë ke
e ke t'marsh ata ç'gjën.
Prir ti sizit ka it at,
të t'e jár tij at urat:
se edhe sonde fjë ti vet
e nesembrëma si të nget;
edhe sonde je me prindin,
se nesembrëma je me trimin.
Nesembrëma, kur t'jet hera,
me di sallàçe mbullihet dera
e te nj'kushin vëhen di krera.

* *E rrëfjejtí Maria Markut / Maria Miranda, ka Purçilli, ditën 21-8-1973 (Material i marrë ka tezja llàwes së A.Xhordanit "Poesia popolare a Frascineto e Eianina", Univ. La Sapienza, Roma, a.a. 1973-74).*

(1 - ka më)

Shërbime, toponime e fjalí

Giulio Peta

nga Garrafa (Cz)

- Sot bënëjmë brumin, menatë bënëjmë bukun - oggi prepariamo il lievito, domani facciamo il pane
- Sot vemi pi riqe ka "Rinati" e menatë vemi pi dru ka mali - oggi andiamo per erica al "Rinachio" e domani per legna in montagna
- Na marrim ujtë ka "Kroi madh" e ju e mirrni ka "Kostandini" -noi prendiamo acqua alla "Fontana Grande" e voi la prendete da "Costantino"
- Na vemi te kroi e Nxhiks e bënëjmë vukatën me hi - Noi andiamo alla fontana di Francesca e facciamo il bucato con la cenere
- Kallaremi ka Purrafela e vemi të "Usiti" - Scendiamo da "Purrafela" (burrone profondo) e andiamo nella località di "Usito" (accampamento di soldati)
- Dje na shtripoj llopa e dhia - ieri ha perso il latte la vacca e la capra
- Sot na dishtroj llopa e dhia - oggi ha abortito la vacca e la capra
- Dje na puall gadhjura e delja - ieri ha partorito l'asina e la pecora
- Gadhjura është barsë - l'asina è incinta
- Ime shoqe është e mbaracuuar - mia moglie è incinta
- Gruaja ime ju skansua - mia moglie ha abortito
- U jam keq - io sono ammalato

- Llopa është sëmure - la vacca è ammalata
- Pi tre ditë rëmonjëm ka mali e pra vemi ka poshtë - per tre giorni zappiamo in montagna e dopo andiamo in pianura
- Mbjëdhnjëm rusht e pra shtipinjmë me këmb te parmensi - raccogliamo l'uva e poi la pigiamo con i piedi nel palmento
- Lirin më parë e shtipinjmë me manganin e pra e krihinjmë me kardin - il lino prima si schiaccia con il mangano e poi si pettina con il pettine di ferro
- Më parë lúanjmë djatht ka Karrerat - prima si giocava il formaggio in località Carrera
- Ai ha si një derk - lui mangia come un maiale
- Me dhemat bënëjmë thimónjnë - con i covoni facciamo le biche
- Shprishinjmë dhematë te lljami e pra shtipinjmë me llop - spargiamo i covoni sull'aia e poi li pestiamo con le vacche
- Kur frin era te lljami fluturonjnë hjuska, kalli e gruri - quando soffia il vento nell'aia, volano la pula, le spighe e il grano.

Konkurs Poezije "Gj. Kastrioti Skanderbeg"

(Edicion 2009, Shoqatë Vatra Arberëshe, Chieri (To))

Sesione Arbëreshe / të vigjël

Katia Forte
e para, ka Ungra (Cs)

Pramvera

Shqiten lulet ka gërshia
bien fjet fjet si borë,
duken edhë kulëndra kur
nusja vë kurorë
e shtrojin dheun
me një palacë
e gjatë, e gjerë bracë bracë.
Ka rahji zë e verdhen spartat,
rreth gielbron bart të ri
e zogitë këndojin me hajdhi,
ndërsa liveret tunden
e shkunden me erin
e një dielli i ngrohët i terin.
Ajër i pastër, naturë e bukur,
pjot mellodí,
çë kënaqëzon zëmir, vesh
hundë e sy.

Primavera - Si staccano i fiori dal ciliegio, /scendono i petali lievi lievi
come la neve, /sembrano confetti che volano /nel giorno degli sponsali /e
coprono il terreno /con una coperta / lunga, bianca, larga. / Sulla collina
cominciano a fiorire le ginestre, / verdeggia l'erba novella /e gli uccelli can-
tano allegramente / mentre panni stesi / ondeggiano al vento / e un sole
caldo li asciuga. / Aria tersa, pulita, natura bella, / melodiosa / che appaga
cuore, orecchie, / olfatto e vista.

Sesione Arbëreshe / të mëdhenj

Francesco Scaravaglione
i pari; spixanjot, San Miniato (Pi)

Vjershe

E të shoh çë hipe si një nele e holl
dal dal ka rruga e sipër një troll
mbrushnare e nise si e madhe llavin
kur ka vinela kërkon një trim ...
Një trim çë të merr të mbëson e thurret
pse ti si mëmë, ti je si tat
ti je si far çë te bota rritet
e pas ka qiella e madhe mbihet
Vjershe vjershe vjershe
më shket te zëmra si një mesh
kur i magjepsur të gjegjinj se shkon
jasht ka dritsora e u pjot me gjum Zgjohem!!!
E hapinj syt te gjuha çë bired
e hapinj vesht te kënga çë viret
te kta vinele pa mosnjeri
çë më ngatrehen te kta sy ...
E të shoh çë më siell prallza e fjal

çë më sillnjen prapa kur isha djal e
si një magji më hapet si lum
një mendje çë disha e bjer ndë gjum!
Vjersh vjershe vjershe
më shket te zëmra si një meshë
vet tek ti u gjënj fuqin
të sallvonj ka vdeqa, oj, gjuhen time!

Vjershe - E ti vedo che sali come una nebbia fine / pian piano dalla
strada e sopra il terreno, / ti trascini e vai come un grande rivolo / quan-
do cerchi dal vicolo un giovane ... / Un giovane che ti prenda, ti insegni
e ti gridi / perché tu sei madre e padre / tu sei come un seme che cresce
nella / terra e che dopo si aggrappa al cielo ... / Vjershe Vjershe Vjershe
/ mi scivoli nel cuore come una messa / quando ammalato ti sento che
passi /f uori dalla finestra e io assonnato ... Mi sveglio!!! / E apro gli
occhi alla lingua che si perde / e apro gli occhi al canto che si appende /
tra questi vicoli senza nessuno /che mi si attorcigliano tra gli occhi ... / E
ti vedo che mi porti favole e parole /che mi riportano indietro quand'ero
/ bambino e come una magia mi si apre / come fiume una memoria che
credevo / persa nel sonno! / Vjershe vjershe vjershe / mi scivoli nel cuore
come una messa / solo in te io trovo la forza / di salvare dalla morte la
mia lingua!

Sesione shqipe standard

Vilhelme Vranari (Haxhiraj)
e para; ka Vlora, Shqiperi

Rrenjët

Rrenjët ...
këtu i mbollën,
në këtë tokë të larë në gjak.
Degët ...
nëpër botë janë shpërndanë
Syri ...
lot pikoi,
kur dritën e së vërtetës ai pa ...
Gjuhën e mëmës ...
ëmbël shqiptuan,
atje, ku rrenjët hodhën shtat.
Horizontet e përflakura shijuan ...
aty,
ku blegërin qengji manar Nëpër botë kërkuan, askund nuk i panë,
u kthyen e i gjetën rrenjët ...
aty, ku i lanë

Le radici - Le radici / Qui le piantarono / in questa terra /lavata
di sangue ... /I rami ... / si sono sparpagliati nel mondo. /
L'occhio ... /lacrime versò, /quando la luce della verita' avvisto'.
/ La lingua materna ... / pronunciarono dolcemente, / li ... dove
le radici si sono messe. Gustarono gli orizzonti fiammeggianti /
li, dove l' agnellino correndo li segue belando ... /Le cercarono
per il mondo, / da nessuna parte le videro / Ma ritornando le
hanno trovate, / le radici ... / li', dove le avevano lasciate

Laureta Petoshati

nga Vlora (Shqipëri)

Në Vlorë, në rrugën "Agim Ramadani"

Barbaroza

U rrit në saksi barbaroza,
gurgulloi një fllad të jeshiltë,
dhe pse s'ka shtatin si mimoza
ia përshkënditi aroma gjinjtë.

Ia këputën gjithë vitin
fletët, si një lezmë e mbytur,
qajnë dhe veten përtëritin
të merme, vesë-vesitur.

Barbaroza tharm-stolisur,
e vogla, gjithë-gjelbëruar,
fjalëz-dritë -sapunisur,
fërfërimë - menduar.

Barbaroza - është një bimë me erë të mirë, me gjethe si pëllëmbë të vogla e me push, lulet i ka të vogla në ngjyrë trëndafili. Kjo bimë përdoret për aromë të mirë në gatim.

I mermë - që ka e lëshon erë të mirë.

Gjinkalla e detit

Zëra-zëra, rrëzëllima,
rritur- ndritur në thelloma
ku ylberi e vetëtima
takohen veç në aroma.

Zëra-zëra-zëzëllimë,
heshnja të përskuq vetminë,
zëra-zëra, astakua,
dritë nga yjet donte hua.

Zëra-zëra, shkularake,
hark në çarkun e një gracke.
Ulërimë! Shpërdredhje ! Shfrime!
Meket vaji në gulçime...

Det-përflakur zemërimi,
ylltuar nga hidhërimi,
me mozaikë rebelimi...

Gjinkallë deti, moj gjinkallë,
fati yt ndez një mangall...
Ngjizur shijet në një plektër,
afsh e ethe, shkulm në spektër!

Mishin, shijen si poemë...
Këngën, vajin për bohemë...
Ndërsa klithmën për zgalem...

Gjinkalla e detit - është një karkalec i madh deti që rritet në thellësi shumë të mëdha, i cili në Vlorë quhet astakua, (në Itali është një tip i asaj që quhet aragosta) por kur kapet dhe del në sipërfaqe të detit lëshon një zë të klithët si të gjinkallës.

Të shkosh në agim, në rrugën "Agim Ramadani",
në uverturën e mëngjesit mesdhetar,
kur nisen anijet përtej një limani,
çikërron, pikon vesa në margaritarë...
Një doçkë ngre një katana si krahë pulëbardhe,
lart mbi maja palmash që pjalmojnë lulesa,
nuk është më i plumbtë qielli i kësaj ane,
as kufij shqiptarësh s'do ketë më, në breza.

Jemi në Vlorë. Çdo rrugë e ka një emër,
çdo emër flakërimë e vetëtimitës,
qiellit ia shkroi lavdinë mu në zemër,
filigran i artë: gjaku i shqiptarizmës.

Kur vjen nata, ahu i shpirtrave të zgjuar,
që s'u prehën kurrë nga dhimbja e sakatimi,
në këtë liman të qetësisë, i gjen bashkuar,
mes Isës, Ismail Qemalit, vjen dhe Agimi:
- Eja bir, o djalë, Agim!
- Ç'frymë shenjterie, me ty, Vlora paska!
Deti si telajo pikturon lirinë,
qielli, vargje -vargje, mban pezull pallaska.

Të shkosh në agim, në rrugën "Agim Ramadani",
në Vlorën e kthyer tashmë në një Mekë,
në një palë Flamuri, gjaku i këtij vigan,
Agim mes agimesh, mallëngjen e prek...

Vlora, më datën 15 dhjetor 2008 me Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 52, pagëzoi me emrin "Agim Ramadani" një rrugë të saj, këtij dëshmorit të kombit shqiptar që ishte dhe poet e piktor i njohur në Europë.

Katana - është lodër fëmijësh, që bëhet me copa letrash dhe ngjitet si balonë duke e mbajtur me spango apo fill, por Katana ka qenë dhe pseudonimi i luftës së poetit Agim Ramadani.

Lulesë - lule të grumbulluara në trajtë rrethi, poshtë krahëve të palmës.

Pallaska - ka kuptim të përgjithshëm edhe për zburimet ushtarake, edhe për medaljet apo qese lëkure apo metalike për të mbajtur fishekët, apo barutin.



Zëra - apo Zana është figurë e mitologjisë shqiptare që përfytyrohet si vajzë shumë e bukur dhe luftarake, e cila jetonte në male dhe pyje, u ndihmonte trimave, por kishte edhe fuqi të tjera ndëshkuese; vjen nga fjala zë apo za, ashtu si vjen dhe fjala Zeus, që në shqipen e vjetër është Zëri i udhës, pra vetëtima.

Plektër - është vegël, e cila u jep dridhje kordave të lirës që ka qenë një vegël muzikore në lashtësi. (në italisht pletrro)

Te praku i Qishës

Si do t'zgjedhim peshkopin e ri ?

Arbri Roman

ka Roma

Ndoni këtë herë arrvoi i pari. Kalivja e asaj gruaje që shet xhornelet kish mbillur. Gjindja shkoj përpara statues e Babuinit, ruaj e ikij. Kumbora e rrëloxhit të shën Thanasit kish ranë orën nëndë. Pastaj errdhi Kozmai e pra u bashkua edhe Gjergji. Grupi i tre miqve nani ish te praku i qishës. Flisin për hënzën e re, që t'dukej një pasiqyrë ndë qiell.

Kozmai mori e tha: "Mëngu hënza këtë lart di kuji bëjnë peshkop për arbëreshët e Kalavrisë!"

"Eee... nani - ja prori Gjergji nga Hora - mos e bëj kështu të ngatërruar shurbesin! Një peshkop shkon e një'tër vjen. Si thuhet? Peshkopet lidhen një me jetrin njeri tek apostujt, e këtu Romë Papët arrovjnë njeri tek shën Pjetri!"

Kozmai mori pameta fjalën:

"Është vërtetë - tha me paçenxë - ma s'është kështu e qartë. Ka sembri probleme. Një do si peshkop njëji e jetri do një'tër. Një preferon një peshkop i butë dhe jetri një peshkop me shkop! Një e do të ri dhe jetri e do plak. Një e do konservator e jetri e do modern. Kur qeva ndë katund, një mik më tha: "Jo, jo, ai s'mund t'jetë peshkop, ai nëng siall kamilafkin kur thotë mes-hën!"

Gjergji spjegoi:

"Kur bën peshkopin tek na, u bën fjalë mbi fjalë! Pra Roma zgjodhi një që s'e pensoj mosnjeri. Katundet e tona, si gjithë katundet e vogla, janë pçikalitke, rashkaren si maçe, ma pastaj janë të urta, pse thon se një vëlen jetrin. Nganjë ka pjesën e mirë. Mjafton se ti ruan këtë pjesë".

Pushoi pak, pra gjithënjëherje Gjergji tha:

"Ndëse është kështu difçili të zgjedhin një peshkop gjithë bashkë, mund t'bëjnë si bën apostujt kur zgjodhëtin apotullin e sprazmë, Matian. Shkruajnë emrat e gjithë priftravet ndë copa karta, një'emër nga copë; pra marrin një shapëkë o një kamilafk, e gjith'ata copa karta i vënë atjë mbrënda. Gjëjnë një djal pa sy, çikat si thon tek na, e bin'e marr një nga ata copa kartje. Emri ç'është i shkruajtur do t'jetë peshkopi i ri. Ndëse i thonë Papës se e zgjodhtin kështu, u thom se Papa e merr për t'mirë".

Ndoni s'kish hapur buzët. I dukej një diskurs pa këmbë e pa krie. Por s'i dukej mirë t' mos thoj faregjë. Kështu mori e tha:

"Ma s'është kaq e lehtë t'gjësh një kriatur çikat. Te katundi im s'njoh mosnjeri".

Gjergji që kish bërë këtë propozicion pensoi një cikë e tha:

"Mëngu tek katundi im gjëndet një kriatur çikat!"

"Mëngu tek na"- shtoi Kozmai. Foltin mbi kriaturat e sotshme që janë më të shëndoshta. Dhe, për graxjen e shën Lluçies, duket se kanë sy të mira. E pra jatronjtë sod janë më të urta".

Edhe zgjedhja nga një çikat dukej se s'vej mirë; s'kish rrugë-dalje, si thonë Koc-Picut.

Ndoni, si i lodhur, tha:

"Peshkopin e bën Papa dhe Papa s'është çikat. Ai do t'zgjedhë mirë".

Gjithë këtë diskurs e kish gjegjur Babuini. Atij i dukej vërtet një diskurs pa krie e pa bisht. Dukej se thoj: "Kanë t'zgjedhin një peshkop e flasin për çikata".

Antonio era giunto per primo questa volta. Il chiosco della signora che vende i giornali era già chiuso. La gente passava davanti alla statua del Babuino, dava uno sguardo e si allontanava. La campana dell'orologio di S. Atanasio aveva suonato le nove. Poi sopraggiunse Cosmo e quindi Giorgio. Il gruppo dei tre ora era sul sagrato. Parlavano della luna nuova che ti sembrava uno specchio in cielo.

Cosmo incominciò col dire: "Neanche la luna lassù sa chi nomineranno vescovo per gli arbëreshë di Calabria".

"Eee...ora - gli ribadì Giorgio da Piana - non farla così complicata la cosa! Un vescovo passa ed un altro viene. Come si dice? I vescovi si succedono l'uno all'altro fino agli apostoli. E qui a Roma i Papi arrivano fino a S. Pietro".

Cosmo riprese la parola: "E' vero - disse con pazienza - ma non è proprio così chiaro. Vi sono sempre problemi. L'uno propone uno come vescovo e un altro l'altro. Uno desidera un vescovo benevolo e l'altro un vescovo con il bastone. Uno lo vuole giovane e l'altro anziano. Uno preferisce un conservatore e un altro uno moderno. Quando sono stato al paese un amico ha sentenziato: "No! No! Quello non può essere vescovo, quando dice messa non usa il kamilafkion!"

Giorgio spiegò: "Quando hanno fatto il vescovo da noi, si sono fatte molte chiacchiere! Poi Roma ha scelto uno che nessuno immaginava. I nostri paesi, come tutti i piccoli paesi, sono attaccabrighe, si graffiano come gatti, ma poi sono saggi e dicono che uno vale l'altro. Ognuno ha il suo aspetto buono. Basta che tu guardi a questo aspetto".

Si fermò un momento, ma d'improvviso Giorgio aggiunse: "Se è così difficile scegliere un vescovo tutti insieme, possono fare come hanno fatto gli apostoli quando hanno scelto l'ultimo apostolo, Mattia. Scriveranno i nomi di tutti i preti in pizzini di carta, un nome su ogni pizzino; poi prenderanno un cappello o un kamilafkion, e vi metteranno dentro tutti quei pizzini. Troveranno un ragazzino cieco, "cicaco" come dicono da noi, e gli faranno scegliere uno di quei pizzini. Il nome che vi è scritto sarà quello del nuovo vescovo. Se diranno al Papa che la scelta è avvenuta così, io dico che il Papa la accetterà".

Antonio non aveva aperto bocca. Gli sembrava un discorso senza capo né piedi. Ma non gli sembrava bene che non dicesse nulla. Così prese a dire: "Ma non è poi così facile trovare un ragazzino cieco. Al mio paese non conosco nessuno".

Giorgio, che aveva fatto questa proposta, rifletté un poco e poi disse: "Neanche al mio paese c'è un ragazzino cieco".

"Neanche da noi - aggiunse Cosmo.

Continuarono a parlare dei bambini di oggi che sono più sani. E, per grazia di Santa Lucia, hanno buoni occhi. E poi i medici oggi sono più bravi".

Anche la scelta da parte di un cieco sembrava che non avesse sbocco positivo, non aveva via d'uscita, come dicono a Cozzo-Pizzuto.

Quasi stanco, Antonio disse: "Il vescovo lo nomina il Papa e il Papa non è cieco. Lui sceglierà bene".

Tutta la conversazione l'aveva ascoltata il Babuino. A lui pareva veramente un discorso senza capo né coda.

Sembrava che volesse dire: "Bisogna scegliere un vescovo e parlano di ciechi".

Intervistë zotit Manuell Giordano

Udha e T'Inzoti

(interviston) **Agostino Giordano**

ka Purçilli (Cs)

(vjen ka numri 61)

- Mëmes tuaj ja kishet kallëzuar se do të bëhshit prift?

Mëma - sepse mbanej mendë fjalet e zotit lalë Binard Bilota, që thoj: "Mosnjari ka t'i ngasë libret tim ndëse s'është i fëmiles tonë e s'i ndilgon" - më parë se t'ja thoja u, shumë herë më pienej ndëse do të bëhsha prift. Kur ja kallzova të paren herë, ajo patë shumë harë: ndër nëndë biltë e saj, isha u që kisha vërtetuar ëndrren e saj e të zotit lalë.

- Si, e kur, u poq kjo thirrje e t'Inzoti?

Kjo thirrje u le, u rrit e u poq gjatë motit që veja mbë qishë, me fjalët e mira që më thoj prifti i Frasnitës, zoti Viçenx Frashini; e, mëse gjithë, me frimen e t'In Zoti, kur isha vet. E u ndieja se kjo thirrje më sill mbë zëmer një paqë e një gëzim të math.

- E prifti i atij moti që rol patë të kjo thirrje?

Zoti Viçenx Frashini ish shumë i lidhur Qishës, s'lëj të shkonej një ditë pa thënë meshen o funxjonen e mbrëmjes. U, kur kisha nge, veja të mesha, menatet; e mbrëmanet, që s'kisha skollë, veja shumë herë mbë qishë. E pëstaj, dalur ka qisha, ecja me zotin njera jashtë katundit. Ahiera ai më rrëfenej shurbise të mira e më pienej ndëse do t'bësha prift, si zotilalë Bilotta. U e gjegjja e mendoja mbë vetëhë se, ndëse Inzot doj, edhe mua më pilqenej të mirja atë udhë.

- Si rrohej riti bixantin ndër vitet '30?

Kishen shkuar më se dhjetë vjet ç'kur u kish lerë Eparkia e Ungres: te dica katunde zënej e pastrotehje riti bixantin; po më të shumet e lanë ritin grek të përzier me llatinizme, si më parë: ndër këta katunde ish edhe Frasnita. Populli ish i mbësuar ashtu e zoti Frashin s'ndërroi faregjë.

- Ishen shumë statue? E ikona?

Çdo qishë kish shumë statua. U mbanj mend se Qisha madhe, Frasnitë, kish statuen e shën Mërisë Sundes, të shën Mërisë Makullatës, të shën Andonit të Padhues, të Shën Lluçisë, të shën Vlashit, të shën Rokut, të shën Seps, të Shëjtes Kriqje. Tek vendi i ikonave, Qisha e Frasnitës kish dica pitura të mbëdha: të shën Mërisë Sundes, të Shën Sepës... Autari s'ish një, e kuadrat, si doj riti bixantin, po pesë, nganjë i kushtuar një shënjtji. E qisha ish pa ikonostáz. Ndë mes t'katundit, gjëndej qishza e shën Lluçisë: edhe kjo kish tre autare lëtinj, me

statuen e shën Lluçisë, e një piturë tek muri, që figuronej shpirtat e Purgatorit. Pra, jashtë katundit, ish Qisha e Shën Pjetrit, e vitevet 1000, që një herë vej me Monasterin Basilian; kish autarin lëti, kish statuen e Shën Pjetrit e ish pjerrë ka hin dielli; kur kish qënë stisur ka monaqit, ish pjerrë ka del dielli, po kur pra zgjeruan qishen te viti 1600, e bën si doj riti latin. Tek dita shën Pjetrit (29 theristí), bëhej markati tek sheshi qishs, e vijen delaret malsjotë ka Shëllarjenxi; e gjindja thoj: "Erthtin noçrat ndë markat, se të ndërrojen djath për qep!".

- Me një fjalë, ish shumë përzierje ndë mes t'ritevet grek e latin.

Ëh, shumë. Gjuha ç'uzarej mbë qishë ish ajo greke, po ndër dica funxjona, mbrëmanet, uzarej gjuha...llatine; kishen pjerrë në gjuhë greke litaninë llatine "Pange lingua"; gratë thojen Rruzarin te gjuha llatine; mesha këndohej me organin; ndër festat, qishen e veshjen me petkra ndrishe; tek e prëmtja madhe bëjen sumbullkun e atjë vëjen anàmen (eukaristinë) për t'e adhurojen, si lëtinjtë.

- Zoti Viçenx Frashini kish dërguar më frasnjotë te Seminari Grotaferratës?

Qe zoti Viçenx që më dergoj te Seminari i vogel, Grotaferratë. Parë mua kish dirguar Grotaferratë edhe Sepë Ferrarin e Mink Bellicin; e, pas meje, dirgoj edhe Llin Bellicin: të tre këta frasnjotë u bën priftra, si u.

- Ç'ju pelqenej të jetës priftërore? Cila që shkëndila? Qe më fjala e priftit o frima e t'Inzoti?

Më pëlqej shumë udha që kisha zgjedhur. Paremëparë do të xëja më shumë shurbise, jo vet të kësaj jetje, po edhe të jetrës jetë (shpirtërore), kështu, pra, të mbësoja edhe të tjerët, ture predhikuar Vangjelin e Zotit Krisht. Më ndihtin fjalza e mirë e zotit Frashin, frima t'Inzoti e dëshira e prindërvet të zgjidhja udhën e priftërisë! E pra më pëlqenej më t'isha delar njerzish sesa delar dhensh, më t'punoja shpirtat sesa dherat.

- E gjindjat frasnjote si e rrojen besën e tire?

Ata shurbjejen dherat o ishen delarë; s'kishen skollë e rrojen besën e tire me shumë thjeshtësi; ndër dherat, o ku gëndëshin, këndojen kalimeret arbërisht; vejen mbë qishë ndër festat e mbëdha, më pak ndër të diellat: edhe këtu këndojen kalimeret arbërisht.

- Cilat ishen funxjonat ku vejet më shumë?

Ato që më pëlqejn më shumë ishen ato të Kreshmevet, të Pashkëvet e të Natallevet, të Shën Mërisë e të dica Shënjtrave. Ndër këto festa i veja pas tatës tim, kur i bij organit e këndonej meshen.

- E te gjuha arbëreshe që këndohej mbë qishë?

Gjuha e parë e qishës ish ajo greke, pra vinej gjuha arbëreshe, me kë këndohshin Kalimeret. Më parë se zoti Frashin, ish prif i Frasnitës zoti Binard Bilotta, stërlala im: ki bënej katekizmin arbërisht e predhikonej arbërisht. Te gjuha llatine këndohej litanian, thohej rruzari e më gjë; te gjuha talljane këndohej ndonjë kalimere Shëjtravet o Shën Mërisë, e marrë ka qisha lëtime.

- Ishen edhe të tjerë priftra bixantinë, Frasnitë? E Purçill?

Njoha, nd'ata vitra, edhe te tjerë priftra frasnjotë, si zotin Ëngjell Ferrari e zotin Mink Magnelli: i pari ish profesor, Kosenxë, te Lliçeu "Bernardino Telesio", e vinej hereherë Frasnitë të gjënej gjiritë; i dijtji bëri priftin Purçill për pak mot e pëstaj shkoj ndë Horet (Castrovillari) e te lliçeu mbësoj llatin e grek: edhe ki rrallë vinej Frasnitë të gjënej gjiritë. Njoha edhe priftin Sepmarien Pellicano, çivitjot, që vinej ndonjë herë, Frasnitë e Purçill, për të ndihnej priftrat e këtime katundeve. Prifti Purçillit, ndër vitet 1929-1938, që zoti Frangjisk Camodeca, i kushtërii arkimandritit Pjetër Camodeca i Koronenjvet, ka Kastëmxhi. Më parë se Camodeca, që prift i Purçillit zoti Viçenx Ferraro (1923-28), ka Ferma. Zoti Viçenx Frashini për ca monje, te viti 1928, venej edhe Purçill, si "economu curato", kur atjë s'ish prift.

(3 - është më)

Arbërishtja për Arbëreshët

prof. dr. Ardian Ndreca

nga Shiroka (Shqipëri), Pontificia Universitas Urbaniana (Romë)

Ua kam lakmi arbëreshëve kur i ndie tue folë shqipen e para 500 vjetve. Po, po, lakmi, pse shoh e ndiej me qindra shqiptar që s'i kanë as 10 vjet në emigracion e flasin një shqipë me të marri vaji. Krye dy - tri fjalësh fusin një italisht, anglisht. Sintaksa e tyre s'ka gati kurrigja prej shqipes e kështu që mendimet dalin të përcuduna.

Ndiej arbëreshët e shoh në ta Arbninë e vërtetë, at' që shekujt e kanë shue tek na.

Kur ishte gjallë Ernest Koliqi e vuni Institutin e Studimeve Shqiptare pranë Universitetit të Romës në shërbim të arbëreshëve. Aty studjuen për gati 3 dekada me qindra të rinj e të reja arbëreshë që mandej u kthyen në katundet e tyre tue e gjallnue atmosferën kulturore e tue e ruejt gjuhën.

Mbas vdekjes së Koliqit shumë gjana kanë shkue e janë harrue. Edhe arbërishtja, për arsye të shumta, po humb terren pak nga pak.

Mungon interesimi e mungojnë projektet politike. Ka zyra, funksionarë, ka edhe pare, por nuk ka ma vullnet politik dhe qytetar, siç kishite në kohë të Koliqit, për me gjallnue përdorimin e arbërishtes në Itali. Nuk gjallnohet arbërishtja vetëm tue promovim libra apo studime erudite, gjuha duhet mësue në shkollë dhe duhet përdorë në shtëpi.

Çka me ba atëherë do të thotë dikush?

Asht koha me gjallnue marrdhanjet kulturore me Shqipinë, sidomos me institucionet përkatëse, mbasi kultura arbëreshë ka nevojë për zhvillimet e letërsisë shqipe dhe ka nevojë për me e zgjanue frymëmarrjen e vet, ashtu si edhe shqipja ka nevojë me zbulue vetveten përmes letërsisë arbëreshë të hershme dhe bashkëkohore si edhe nepërmjet vetë arbërishtes.

Gjithsesi arbërishtja ruen identitetin e vet dhe vijon zhvillimin e vet të natyrshëm.

Ernest Koliqi, tue qenë shkrimtar ndër ma të mëdhajt e shekullit të kaluem, nuk pritonte dhe nuk i vinte marre me shkue vetë gjatë pushimeve verore në Kalabri e me i mësue arbëreshëve gjuhën dhe sidomos letërsinë shqipe.

Sot ka mjaft sportele gjuhësore dhe ka mundësi me përgatitë mësues të arbërishtes, nuk mungojnë as gramatikat dhe as fjalorët e arbërishtes, e megjithatë përdorimi i saj po zbehet dita me ditën, të rinjtë nuk e mësojnë dhe nuk e njohin ma si prindt apo gjyshat e tyre.

Kjo gja duhet të na bajnë me mendue, pse oazi i arbërishtes asht tue u mpakë dal ka dalë e pasunia e pesë shekujve po rrezikohet seriozisht.

Invidia gli arbëreshë - scrive A.Ndreca - quando li sento parlare nell'albanese di oltre 500 anni fa. Sì, invidia, perché vedo e sento centinaia di albanesi d'Albania, che non hanno ancora dieci anni di emigrazione e che parlano un albanese che fa pena. Ogni due-tre parole ci mettono una parola italiana o inglese. La loro sintassi non ha quasi niente dell'albanese e i pensieri ne escono sfigurati. Sento gli Arbëreshë e vedo in loro l'Arbëria vera, quella che i secoli hanno spento in noi. Quando era vivo Ernest Koliqi, mise l'Istituto di Studi Albanesi dell'Università di Roma a disposizione degli Arbëreshë.

Lì studiarono, per quasi tre decenni, centinaia di giovani e ragazze arbëreshë, che poi tornarono nei loro paesi rivitalizzando l'atmosfera culturale e conservando la lingua. Dopo la morte del Koliqi molte cose sono cambiate e dimenticate. Anche l'arbërishtja, per motivi diversi, perde terreno poco a poco. Manca l'interesse e mancano i progetti politici. Ci sono uffici, funzionari, soldi, ma non c'è più volontà politica, come c'era al tempo di Koliqi, nella rivitalizzazione dell'uso dell'Arbërishtja in Italia. Non si rivitalizza la lingua arbëreshë solo

(ec te faqja 23)

Vorea Ujko, poet i veçantë

prof. dr. Klara Kodra

Universiteti shtetëror i Tiranës (Shqipëri)

Në yllësinë e larmë të poezisë bashkëkohore arbëreshë Vorea Ujko spikat si një yll me dritë të veçantë.

Poezia e sotme arbëreshë është larg mohimit të traditës letrare dhe folklorike të gjindjes së vet ku ajo sheh rrënjët e saj, po dallohet edhe nga një frymë e theksuar moderne që e afron me poezinë italiane.

Prirja mbizotëruese e kësaj poezie nuk është më epizmi, po lirizmi, jo synimi drejt poemës së madhe, po drejt poezive të vogla që përmbajnë në vetvete shumë mendim dhe ndjenjë, madje më tepër mendim se sa ndjenjë.

Poezia moderne arbëreshë ndryshe nga poezia tradicionale e rilindasve që i jepte një vend të madh ndjenjës, nuk e mohon atë, po e fshih në thellësi.

Një proces i ngjashëm ndodhte dikur te poezia e De Radës (që ndikoi, pa dyshim, te Vorea Ujko), po në rastin e poetit të Maqit ky proces fsheheje të ndjenjës e kishte burimin te kontradikta midis vokacionit lirik dhe synimit epik.

Poezia e sotme arbëreshë nuk e fshih, e shpall hapur lirizmin e vet, po ajo është e prirur drejt një vetpërmbajtjeje në të shprehurit e ndjenjave, drejt një meditim filozofik.

Vorea Ujko e shpreh këtë tipar të përgjithshëm të poezisë së sotme arbëreshë në krijimtarinë e vet poetike, po duke i dhënë vullën e vet vetiakte, vullën e një individualiteti të fuqishëm.

Në pseudonimin e vet shprehës Vorea Ujko - Domenico Belici mendojmë se ka simbolizuar vullin e erës (Vorea) që karakterizon dinamizmin e poezisë së tij dhe një lloj ashpërsie apo egërsie primitive dhe spontane (e simbolizuar te ujku) në kritikën që ai i bën realitetit.

Poezia e tij ka përmasa filozofike dhe sociale: një nga temat e tij të parapëlqyera që janë edhe vatra tematike në krijimtarinë e tij është mekanizimi i jetës që rrezikon vlerat tradicionale, vlerat tradicionale të një bashkësie që mbijetoi pikërisht duke luftuar për ruajtjen e zakoneve të veta.

Vorea Ujko e ndjen veten arbëresh dhe shqiptar; i ndjen shqetësimet e bashkësisë së vet si minoritet dhe lidhjet me atdheun e të parëve, po njëkohësisht është bir i kohës së vet si njeri dhe si poet.

Në poezinë e tij ka edhe realizëm, po edhe koncentrim të thellë të fjalës, tipar karakteristik ky i poezisë së shekullit të njëzetë, ai është më tepër modern se sa modernist: nuk priret, bie fjala, nga hermetizmi.

Tema erotike zë pak vend në poezinë e tij, po lirikat e tij të dashurisë janë plot optimizëm, vitalitet dhe etje për të bukurën, të afërta me poezinë popullore arbëreshë, po edhe të pasura me nëntekst filozofik.

Ujko provon edhe lloje më të mëdha të poezisë, po poemthin, jo si dikur poemën e madhe epike.

Poeti synon të shkruajë në gjuhën e sotme shqipe standard, ndonëse ruan disa konstruktive arbëreshë.

Ky ideal gjuhësor ka ndikuar në qartësinë dhe forcën shprehëse të leksikut të tij.

Poezia e Ujkos i bëri ballë provës së kohës, ajo jeton dhe na e risjell të gjallë poetin, njëzet vjet pas zhdukjes së tij fizike.

Nel panorama della poesia contemporanea arbëreshë - scrive Klara Kodra - Vorea Ujko spicca sugli altri. La poesia arbëreshë di oggi si barcamena tra la propria tradizione letteraria e la poesia moderna italiana. La sua vocazione predominante non è più l'epicità ma il lirismo, non più i poemi ma le poesie brevi, che contengono in misura maggiore pensiero anziché sentimento. Nella poesia del De Rada, che ha influito su Vorea, questo nascondimento del sentimento derivava dalla sua contraddizione tra vocazione lirica e scopo epico. Oggi, nella poesia odierna arbëreshë, il lirismo subisce più autocontrollo nell'espressione dei sentimenti, quasi

(ec te faqja 19)

E folmja e Himarës dhe të folmet arbëreshe

Helena Grillo, M.A.

pedagoge në katedrën e gjuhës shqipe, Universiteti i Vlorës (Shqipëri)

Në studimet e derisotme gjuhësore kemi ndihmesa të pasqoqë për njohjen e gjuhës së arbëreshëve të Italisë, veçorive strukturore të tyre, leksikut e pikat e përbashkëta me gjuhën e trungut mëmë. Dëshmitë e shumta gjuhësore argumentojnë fazën më të hershme, e prerjen sinkronike më të vjetër që ruhet me kujdes përballë ndikimeve nga italishtja e erës globalizuese që shfaqet në gjuhën shqipe standard.

Do të ishte me interes studimi i këtyre të folmeve, jo vetëm për faktin se janë rasti i shfaqjes së gjuhëve në kontakt, por edhe për karakterin tepër ruajtës e konservativ që shfaqin në rrjedhë të shekujve. Paraqitja e pikave të përbashkëta mes këtyre të folmeve do të ndihmojë jo vetëm dialektologjinë, por do të mbeten dëshmi me vlerë në fushën e historisë së gjuhës shqipe, duke ndihmuar në rindërtimin e fazave më të hershme të shkrimit të gjuhës shqipe.

Mes këtij punimi do të shqyrtojmë pikëtakimet e të folmeve të arbëreshëve të Italisë e të folmeve ruajtëse të krahinës së Himarës, si pjesë strukturore e të folmeve të Bregut. Arbërishtja paraqitet si një unitet në larminë e përgjithshme të dialekteve të shqipes; një grup të folmesh mjaft të afërta me njëra-tjetrën, një formë dialektore më vete të dallueshme me dialektet e saj. Një formë që nuk është e njëjtë me asnjë nga dialektet e atdheut. Strukturalisht i përket toskërishtes jugore, (nenvizohen karakteristika të përbashkëta me nëndialektet e shqipes:

Labërishtja e Camërishtja).

E folmja e Himarës paraqet interes të jashtëzakonshëm studimi si e folme e një krahine me probleme të kontakteve gjuhësore. Me interes do të ishte studimi i këtyre të folmeve në faza të ndryshme të zhvillimit të tyre duke u trajtuar si gjuhë në kontakt e duke shqyrtuar problemet që shkaktajnë gjuhët në kontakt.

Në këtë të folme anësore të shqipes ruhen si trajta të vjetra gjuhësore, ashtu edhe fjalë e forma fjalësh nga dialekti i toskërishtes jugore (të cilit i përket), por edhe ndonjë dukuri që, për çudi, përkon me trajta të dialektit të Veriut.

E folmja e Bregdetit Jugor shqiptar, ku bën pjesë edhe e folmja e Himarës, nuk mund të veçohet nga të folmet e tjera të dialektit jugor të gjuhës shqipe dhe, ashtu si këto, i është nënshtruar një evolucioni të pandërprerë qysh nga kohët e lashta. E ky evolucioni i gjatë me karakter dialektor dhe nëndialektor parakupton një prani të pandërprerë të elementit të vjetër autokton, i cili, me gjithë trysnitë e shumta, sidomos gjatë pushtimit romak, ka mundur ta ruajë identitetin e vet etnik, ashtu si etnosi arbëresh në përgjithësi. Arbërishtja ka 6 zanore: a, e, ë, o, i, u. Arbërishtja paraqitet me mungesën e zanores "y" duke shkuar kështu paralelisht me të folmen e Himarës e duke i bërë të dallueshme me shqipen standard. E folmja e Himarës bën pjesë në arealin gjuhësor me dy seri fonemash

gojore, një palë të shkurtra dhe një palë të gjata, të cilat paraqiten me një seri më pak, sepse u mungon fonema y.

Në pasojë të mungesës së fonemës y në sistemin fonologjik të të folmeve arbëreshë dhe në të folme të skajit jugor të toskërishtes, dalin me ie edhe fjalët që në të folmet e tjera të shqipes kanë ye, si p.sh.: krie "krye", të lier (< të liyer "gjalpë")

Në vend të zanores y në këto të folme përdoren zanoret i dhe u. Zanorja i përdoret në: tire, dallëndishe, di (dy), frimë (frymë), griqë, ill, ki (ky), mbill, mbitëm, përrip, qiqë, si (sy), tim (tym), etj. Në fjalët që përmbajnë togun ye, me y të theksuar, në këtë të folme kemi ie me i të theksuar, p.sh.: kërcien, thiej, ngjiej, liej, i rrëmbier. Ndeshim edhe trajta të posaçme si pjesë, pjesë.

Ndikimi i italishtes dhe i dialekteve të saj në shumë sfera i është përshtatur strukturave të arbërishtes, duke mbetur kështu si dy sisteme gjuhësore më vete.

Në të folmen e himarjotëve theksi në fjalët e huazuara nga turqishtja bie në rrokjen e fundit, ashtu siç ndodh edhe në të folmen e Kurveleshit e Vunoit. Theksi është ruajtur si në turqisht, hallë, mashá, supá, kafe, para, boja, kazma, baba.

Interesant është theksi tek emrat e njerëzve. Zakonisht emrat femërore marrin një ë-fundore që mban edhe theksin. Alsidë, Kristinë, Janullë, Lenë, Klemendinë etj...

(1-ka më)

(vjen nga faqja 18)

Vorea Ujko, poet i veçantë

diventa una meditazione filosofica.

Anche Vorea Ujko esprime questa caratteristica, ma le dà la propria forte impronta. Dimostrando già nel suo pseudonimo, dove ha voluto simboleggiare l'impeto del Vento, che caratterizza il dinamismo della sua poesia, e una sorta di asprezza primitiva e spontanea, simboleggiata nel Lupo, nel criticare la realtà.

La sua poesia ha dimensioni filosofiche e sociali; uno dei temi preferiti è la meccanicità della vita, che minaccia i valori tradizionali della sua comunità. Vorea U. si sente arbëresh e albanese, vive le inquietudini della minoranza e i legami con la madrepatria, ma è figlio del suo tempo. Nella sua poesia c'è realismo ma anche profonda concentrazione della parola, tipico della poesia del sec.XX; ma è moderno piuttosto che modernista, non è ermetico.

Il tema erotico trova poco spazio nella sua poesia, ma le sue liriche sono piene di ottimismo, vitalità, vicine alla poesia popolare arbëreshë, ma ricche di sottintesi filosofici. Ha provato anche il poemetto, ma non il grande poema epico.

Il poeta scrive nella lingua letteraria standard, anche se conserva alcuni costrutti arbëreshë. Questo ha pesato sulla chiarezza e forza espressiva del suo lessico.

La poesia di Vorea Ujko vive e ce lo riporta indietro vivo, vent'anni dopo la sua scomparsa.

Negli studi linguistici odierni abbiamo aiutato impareggiabili - scrive H.Grillo - per la conoscenza della lingua degli arbëreshë d'Italia, delle loro particolarità strutturali, del lessico e dei punti comuni con la lingua-madre. La fase più antica e il piano sincronico più vecchio, che si conserva con cura di fronte agli influssi dell'italiano dell'era globalizzante. Sarebbe interessante un loro studio, specie per il loro carattere molto conservativo che dimostrano nello scorrere dei secoli. La presentazione dei punti comuni in mezzo a queste parlate aiuterà non solo la dialettologia ma la storia della lingua albanese, aiutando la ricostruzione delle fasi più antiche della scrittura della lingua albanese.

In questo lavoro - scrive la Grillo - esamineremo i punti di incontro delle parlate arbëreshë e le forme conservative della regione di Himara, come parti strutturali delle parlate della Costa. L'Arbëreshë si presenta come un'unità nella varietà dei dialetti dell'albanese; un gruppo di parlate abbastanza vicine l'una all'altra, una forma dialettale a sé stante. Una forma che non è uguale con nessuno dei dialetti della madrepatria. Strutturalmente appartiene al dialetto toscano del sud: ha caratteristiche in comune con i sottodialetti dell'albanese, labërishtja e camërishtja.

La parlata di Himara presenta interesse straordinario di studio, come parlata di una regione con problemi di contatti linguistici. Sarebbe interessante lo studio di queste parlate nelle fasi diverse del loro sviluppo, esaminando appunto i problemi che causano le lingue in contatto. In questa parlata dell'albanese si conservano forme antiche albanesi,

(ec te faqja 27)

Dhimitër Kamarda i shkruan De Radës

prof. dr. Italo Costante Fortino

nga Shën Benedhiti (CS), Universiteti L'Orientale, Napoli

Livorno 30 luglio 1880

Carissimo De Rada,

Ho ricevuto la vostra lettera del 20 spirante, ed ho riscosso le £ 23,40 del vaglia racchiu-
sovi, le quali manderò quanto prima al Sig.r
Mitko. Mi giunse gratissima la vostra lettera
dopo tanto tempo che non vedeva i vostri
caratteri, ed anzi aveva in mente di scrivervi
sì per domandarvi se vi era giunta copia e
notizia dei libri stampati a
C(ostantino)p(o)li dalla Società Albanese
per la Stampa di libri alb(anesi), sì ancora
per chiedere vostre nuove, e dei lavori vostri
o di altri Albanesi di quelle parti. Poiché
dopo il 2° volumetto stampato nel 1873 non
ne ho veduto altri. E dissi 2°, sebbene abbia
titolo di III, perché contiene il Canto II, come
il vol. II, contiene il C. P°. Del volume 1° non
ho notizia, a meno che non sia il poema inti-
tolato "Serafina". Dei quali volumi da voi
favoritimi, se non l'ho fatto innanzi, rendovi
ora grazie molte. Imperocché io procuro di
avere tutte possibilmente le produzioni alba-
nesi, ed invero poche mi mancano ancora di
quelle che cose, o la lingua, albanesi riguar-
dano. Se a voi non sono pervenuti i libri della
Società Alb(anese) sopra indicata fatemelo
sapere anche con una semplice cartolina
postale, e ve li manderò subito: sono due
fascicoli dei quali il 1° contiene il regola-
mento della Società, il 2° una specie di
Crestomazia albanese. Io ho salutato di
cuore la formazione di una tale Società come
preludio e principio d'una reale unione fra
gli Albanesi. Le sorte d'Albania purtroppo
non sono felici, e temo molto per il suo ave-
nire. Non par vero che dopo tanto proclama-
re il diritto delle nazionalità si cerchi di
opprimere una delle più interessanti, e che
l'Europa non veda che se vuol mettere un
fermo antemurale allo invadente Slavismo,
può solo trovarlo nell'Albania unita in fede-
razione colla Grecia, od anche a mezzo della
unione personale del Sovrano come
l'Austria-Ungheria ecc., o la Svezia e
Norvegia. Ho letto con molto interesse il
vostro articolo nell'"Avvenire" di Maggio, e
a qualche cosa certo sarà stato utile, ma
purtroppo i nostri mezzi d'azione mancano
affatto, o sono scarsi all'intento. La istituzio-
ne di un giornale italo-albanese, ed abano-
greco sarebbe utilissimo pubblicandosi o a
Trieste, o a Scutari od altrove, ma finora non
ne vedo il principio. Dovrebbe essere scritto,
secondo me, da Albanesi d'Albania per la

intelligenza della nazione, che non com-
prende bene i nostri dialetti, ed esser
dovrebbe uno in ghego, l'altro in toscano per
l'utilità generale. Basta! Speriamo nella
Provvidenza. Voi abbiate tra i vostri
amici, e credetemi sempre
Aff.mo

P. Demetrio Camarda

Dhimitër Kamarda (Hora e Arbëreshëvet
1821 - Livorno 1882) është një studioz
arbëresh nga Sicilia shumë i shpejtë e
shumë interesuar për situacionin politiko-
kulturorë aq të arbëreshëvet sa të shqiptar-
rëvet. Ai ruan si gjëndet kultura e arbëres-
hëvet me konvencionën se gjithë arbëres-
hët, mësemë ata që kanë më shumë sensi-
bilitet për problemet politiko-kulturorë,
kanë të zvelluparin studhet për kulturën,
për leteraturën e për gjuhën arbëreshe e
shqiptare.

Orixhinali i kësaj literje - që publikaret
këtu për të parën herë - gjëndet në
Arkivin e Shtetit të Shqipërisë në Tiranë
(Fondi 24, dosja 54/3, f. 39).

Nga të diavasurit e kësaj literje që
Kamarda i shkruan De Radës mund të
bëjmë tre konsideraciuna:

1. Nga si shkruan Kamarda te kjo liter, si
edhe te dica të tjera litera, na duket hapët se
intelektualët ishin e kriarnjin si një urë që
kish të lidhnj arbëreshët e shqiptarët.
Intelektualët arbëreshë kishin shumë solida-
rietet ndaj vëllezervet shqiptarë që nd'atë
mot ishin edhe ndën dominacionën turke.
Lidhjet ishin personale ndër skritorët dhe
patriotët që ishin të impenjuar për kulturën,
për ringjalljen e nacionës, si na buhtonjën
kontaktat që De Rada e Kamarda kishin me
Thimi Mitko, i cili në vitin 1878 i shkruan
Kamardës një liter ku i rakomandarën dica
patriotë e skritorë shqiptarë me këto fjalë:
"... të tëruanj këi mëk Jan Vreton për njeri
të mirë e të dijshim, edhe të lutem ta duash;
si edhe Spiro R. Dinen patriotin me zemër"
(Thimo Mitko, "Vepra", Tiranë, 1981, f.
622).

Nga gjithë të tjera të rea që mund të djo-
vasen në këto litera del se Mitko, Vretoja,
Kamarda, si edhe De Rada, diskutirin për
alfabetin që, nd'atë mot, edhe nënj ish një
për gjithë, arbëreshë e shqiptarë, për pro-
blemet e politikës, për gjuhën, për varietet-
et e gjuhës, vjen me thënë për dialetet, që
kish të respettoheshin, pse ish kanali më i
mirë për të komunikonjin. Ndë fund të

kësaj literje, Kamarda kur flet për dy
gazeta që kish të shkruheshin nga shqip-
tarët, thotë së ish mirë të shkruheshin një
në dialektin geg, e jetra në dialektin
tosk sa të mund t'e ndiojin gjithë shqiptar-
rët. Kamarda ka përpara syve mësemë të
ndijuarit e gjuhë s e di edhe mirë se
shqiptarët nënj ndionjin mirë të folmet
arbëreshe, kështu si arbëreshët nënj
ndionjin mirë dialetet gegë e toskë .

Duket edhe se ture i shkruar të tre varian-
tet e dialektevet, jo vetëm se na lërejin të
kuptuarit, por nga dialet mund të bëgatinj
jetrin e ndë fund mund të arvohet të
krearet një gjuhë e përbashkët.

Pra tek proposta që Kamarda bën për një
gazetë italo-shqiptare e n'jetër gazetë
shqiptaro-greke, thomse nënj jemi
shumë larg nga e vërteta ndëse thomi se
te kjo propostë fshehet situata politike e
kulturorë e Shqipërisë: një nacionë që
nga një anë ka t' mirrij frymë nga kultu-
ra italiane, dhe nga jetra anë nga kultura
greke.

2. Nga aspekti i politikës, Kamarda ka ndë
mend se gjithë shqiptarët kanë të arvojën
të jenë gjithë bashkë e ndë fund të shtien
nga ngrah dominin e Turqvet. Ai është
dakord me De Radën kur thotë se
Shqipëria ka të ruhet nga Sllavët, por
proponirën një konfederacionë me
Grekët, o të vëhet bashkë me Mberaturin
e Austroungarisë, o edhe me Zvecien e
Norvexhën. Ka të mbajim përpara syve
se De Rada, perkundra, ish edhe kundër
Grekëvet, pse këta kishin ndë mend të
mirrnjin pjesën e Shqipërisë afër
Greçien; me të vërtetë ai shkruan hapët
te rivista "Fiamuri Arbërit" se Shqipëria
kish të ruhej aq nga Sllavët sa edhe nga
Grekët, pse këta dy popuj do të shqyrnin
mbë dy dheun e Shqipërisë dhe të mirrn-
jin një copë për një, kështu se Shqipëria
nënj kish t'ish më si nacionë.

Nga ky aspet, kish të drejtë më De Rada
se Kamarda, pse Grekët ngaherë tentuan
të mirrnjin zonën e Shqipërisë ndë kufi
me Greçien, si edhe sod tentojin të mar-
rin zonën e Çamërisë.

3. - Ndë fund mund të thomi se interesi i
intelektualëvet arbëreshë për librat që
publikarshin ndë Talje o jashtë Taljes

(ec te faqja 24)

Një vepër arbëreshe qe rilind

Florika Tamburi

bibliografe në Universitetin e Tiranës (Shqipëri)

Gaetano Petrotta, një studiues me origjinë italo-shqiptare, në vitin 1931 botoi studimin "Popolo, lingua e letteratura Albanese (tiratura con aggiunte e correzioni)", Palermo 1931, 528 f. Pas ribotimit të dytë të vepërës në vitin 1932, në revistën kulturore e letrare "Leka" të Shkodrës thuhet: "... Se shka është ky liber e ka thanë E. e T. Pavolini "njifarë enciklopedije e Shqypnis letrare..." " Shqypnija letrare nuk i ka vetun kufijt e ngushtë të gjeografisë politike, por ka edhe dy nahije n'Itali, të banueme prej një popullsije mjaft të madhe ". Siç e shohim edhe prej referencave të kohës, kjo vepër është vlerësuar edhe prej revistave të huaja, njëra prej të cilave ishte "La Traduzione", revistë historike, filozofike e letrare. Në vëllimin V të kësaj reviste thuhet "... Ky punim kaq i madh qi pershin 532 faqe të plota në 80, sikur ka dalë prej mendes ashtu është shtypë me të holla t'Auktorit" ("Leka", Shkodër 1932, nr. 9, f. 288).

Vepra u prit shumë mirë si në Shqipëri, ashtu edhe në Itali. Si një vepër që shpreh një dashuri të madhe për gjuhën e vet të origjinës, Akademia Mbretërore Italiane e kohës i dha çmimin inkurajues për një punë të merituar të një studimi të gjatë, për përkushtimin në hartimin dhe botimin me forcat e veta të kësaj vepre. Kurse Qeveria shqiptare e kohës, nëpërmjet institucionit të saj të Ministrisë së Arsimit dhe ministrit të asaj kohe të arsimit, atdhetarit dhe shkrimtarit Hil Mosi, i akordoi çmimin e madh "Komandor i urdhërit të Skënderbeut". Po kështu edhe e përditshmja politike "Besa" në numrin e saj të 296, 12 korrik të vitit 1932 shkruan: "... Shkrimtarëve të Italisë në duhet t'u jemi shumë mirënjohës se, që në kohët më të lashta, ata janë përpjekur burrërisht për independencën dhe për lëvrimin e gjuhës amtare. ... Një tok vjershëtorësh dhe shkrimtarësh arbëreshë na kanë dhënë vepra të vryera, të cilat ne duhet t'i studiojmë me gjithë kujdesjen që meritojnë...Mjerisht, mbase nga shkak se nuk kuptohet mirë nër në dialekti i shqipëtarëve të Italisë, nuk janë dhe aqë të njohura në Shqipëri veprat e De Radës, Jul Varibobës, të Serembes, të Schiró-it" etj. nga të cilat , me një studim të thellë dhe të kujdesshëm, do të zbuloheshin xhevahire të vryera për letërsinë kombëtare."

Vepra është një sintezë e atyre vlerave kombëtare, të cilat kanë qenë në qendër të vëmendjes së të gjithë shkrimtarëve dhe studiuesve të kohës, të cilët shqetësoheshin për ekzistencën e kombit të tyre dhe përpjekshin që me një frymë iluministe dhe patriotike të përmblihd-

nin në veprat e tyre vlerat kombëtare intelektuale shqiptare. Gaetano Petrotta për kohën kur jetoi dhe punoi na ka lënë një fond vepresh shumë të vlefshme. Ai është një personalitet që i përkiste rrethëve elite shkencore. Ai ka qenë i laureuar si doktor në letërsi. Veprat që na ka lënë e dëshmojnë më së miri se Papas Gaetano Petrotta (1882-1952) ka qenë një personalitet me kulturë të gjerë dhe përfaqëson një simbol të idealizmit moral dhe të ekzistencës kombëtare.

I shtyrë prej parimeve idealiste dhe morale, Petrotta është përpjekur që në vepër të pasqyrojë me hollësi vlerat historike, letrare, gjuhësore, gjeografike folklorike e bibliografike të kulturës shqiptare. Përveç autorëve arbëresh, ai ka përfshirë në vepër e vet edhe të gjithë autorët e Rilindjes Kombëtare e deri në autorë si Noli, Konica, Fishta etj., të cilët me vepërën e tyre kanë dhënë një kontribut të çmuar në Lëvizjen Kombëtare shqiptare dhe zhvillimin e përparimin e kombit të tyre. Vepra e Petrotts është jo vetëm një studim antropologjik për nga tematika që trajton, por, kjo vepër monumentale, është njëherazi edhe një vepër enciklopedike. Gaetano Petrotta e shkruajti vepërën e vet në një kohë kur autorë si Jeronim De Rada, Zef Skiroi, Zef Serembe ende nuk njiheshin në Shqipëri; së dyti, kur në Shqipëri mungonin ende shkrimtarët e studiuesit e vërtetë; së treti, e shkroi këtë vepër kur Shqipëria ishte akoma në ndërtimin e Shtetit të Ri Shqiptar; kur në këtë vend mungonin institucionet shtetërore përkatëse dhe ku prapambetja dhe injoranca e trashëguar prej periudhës së pushtimit osman kishte lënë gjurmët e dukshme të një populli të prapambetur.

Ndaj ne brezat e sotshëm të Shqipërisë i jemi shumë mirënjohës këtij arbëreshi patriot, i cili me punën e tij humluese na ka lënë një pasuri shumë të madhe kulturore, duke hedhur themelet e një fondi të filologjisë shqipe në lëmin e albanologjisë shqiptare.

Nuk mund të lemë pa përmendur se kjo vepër u ndalua pas viteve '45, kur në pushtet erdhi qeveria komuniste e Enver Hoxhës, ndoshta për faktin se brenda saj ishin rreshtuar "autorë të ndaluar" për kohën, pasi binin ndesh me zhvillimet letrare të realizmit socialist, një rrymë letrare kjo, e cila sundoi letërsinë shqipta-

re për 50-të vite me radhë. E sot mbas 77- vjetësh do të ishte puna pasionante e përkthyesit Qemal Velija, i cili vendosi t'ia hiqte pluhurin e harresës, duke i dhuruar shkollës shqiptare një vepër kaq të vlefshme. Me përkushtim dhe seriozitet të madh sikurse edhe vetë autori Papa Tani (siç e ka pas quajtur edhe E. Koliqi), ky përkthyes ka bërë një punë shumë të kujdesshme, duke ruajtur jo vetëm origjinalitetin e stilit të autorit, por është treguar i kujdesshëm në përdorimin e shenjave diakritike të shkrimtimit të titujve të veprave, duke bërë që vëllimi të duket sikur autori e ka shkruar drejtpërsëdrejti në gjuhën e sotme shqipe. Vepra e Gaetano Petrottsë ruan po të njëjtat vlera si në kohën kur u shkrua dhe sot ajo fare mirë mund të shërbejë si një tekst alternativ për studentët e degës së filologjisë të të gjitha universiteteve të shqiptare..

Për ta përfunduar, do të kujtonim një shprehje të E. Koliqit, me rastin e dhjetëvjetorit të ndarjes nga jeta të profesor Gaetano Petrottsë: "...[me këtë vepër]...Ky Arbëresh zëmërmadh qi bani me valëvitë në lamije t'albanologjisë flámurin e kulturës shqipe, na lën një shembull qi duhet ndjekë..."

Gaetano Petrotta, uno studioso di origine arbëreshe, - scrive F.Tamburi - nel 1931 pubblicò, a Palermo, il libro "Popolo, lingua e letteratura albanese"; una seconda edizione uscì l'anno successivo. E sulla rivista culturale albanese "Leka" si legge:"Di questo libro E.T.Pavolini ha detto che è "una specie di enciclopedia dell'Albania letteraria". Come sappiamo anche dalle referenze dell'epoca, quest'opera è stata apprezzata anche da altre riviste, come "La Traduzione"; nel suo volume V scrive:"Questo studio così ampio, che comprende 532 pagine, com'è uscito dalla mente così è stato pubblicato con i soldi dell'Autore".

L'opera venne accolta molto bene sia in Albania che in Italia. Come opera che esprime grande amore per la lingua d'origine, l'Accademia Reale Italiana del tempo lo premia per la dedizione nella sua redazione e pubblicazione di tasca propria. Mentre il governo albanese dell'epoca, attraverso il Ministero

(ec te faqja 31)

Monolog psalmesh

Baviola Shatro, M.A.

pedagoge e Letërsisë Shqipe në Universitetin Shtetëror të Durrësit (Shqipëri)

Duke parë panoramën e letërsisë arbëreshe vëren se tashmë prej kohësh e me kënaqësi mund të admirohet jo vetëm letërsia e traditës, por edhe ajo që shkruhet në bashkëkohësi. Nuk është e lehtë të përmbledhësh ligjësitë e zhvillimit të kësaj letërsie sidomos në realitetin e ndërlikuar në shumë plane që ka ofruar shekulli i 20. Veçanërisht vargu arbëresh përbën një mister dhe njëherësh edhe një dhoratë të papërsërtshme në kulturën shqipe. Mënyra e të qenit të kësaj shqipeje, ravgimi i saj për të zënë vend në poezitë e një pakice gjuhësore shkëputur 500 vjet më parë nga burimi i vet, është padyshim një akt sipëror mbijetese. Prandaj është krejt e mundshme dhe e nevojshme të evidentohen dhe trajtohen gjerësisht ata poetë të gjysmës së dytë të shekullit të 20, të cilët krijuan dhe ravijëzuan fizonominë e kësaj letërsie. Më shumë se me emra do të nisja duke përmendur një dukuri (e cila bie në sy qetësisht e disi me drujtje) dhe kjo detyrimisht do na çojë tek një poezi e caktuar dhe tek një poet i caktuar. Dukuria për të cilën flasim është monologu si formë e organizimit të përjetimit dhe të mendimit në poezi, dhe konkretisht shfaqur tek poezia e Agostino Giordanos. Ky autor e ka shkruar poezinë e vet kryesisht deri në vitet '80 të shek.XX.

Monologu që shikojmë në këtë poezi kryhet në dy nivele. I pari është ai i ndjesive dhe i ngacmimeve të shqisave nga një fluks sa i dendur aq edhe i përzgjedhur prurësisht të jashtëm. Gjendja që i mundëson përkapje të tilla, dhe që i tjer për të i çuar drejt monologut të rrafshit tjetër, është ajo e qetësisë, e gjumit dhe e dëshirës. Kur këto rreshtin së gjalluari bie heshtja. Ndërsa monologu në nivelin e dytë, është ai i kujtimit si i tillë në tërësinë e vet, pra niveli i përvojave shpirtërore dhe mendore. Të dy nivelet ekzistojnë të zhytur në njëri-tjetrin, disi të shkrirë në sfondin e një meditim të përgjithshëm për fenomenin e quajtur jetë. Raporti mes këtyre dy niveleve ngjan si një lojë orësh (poezia "*Loje orësh*", 'Bota arbëreshe', fq 36). Në të fanitet hija e njeriut, e cila jo rastësisht të krijon përshtypjen e një kalimtarit të paracaktuar të rropatet udhëve. Por kjo hije nuk është objektive, nuk i përket e botës së jashtme e që më pas mendimi e merr dhe e përpunon për ta kuptimësuar sipas prizmit të vet. Në të vërtetë është pikërisht mendimi ai që e lind hijen. Pikërisht burimi bëhet edhe përshtjelluesi i tij, pasi tek mendimi trajtat e hijes zbehen e përmblyten. Duket sikur ky do të jetë një fillim i ri, por mendojmë se është më shumë vetëdija e përsëritjes së vazhdueshme të bashkëjetesës me veten pavarësisht nga koha apo nga realiteti i jashtëm. Në fund ajo që mbetet në lojën e orëve është hija jonë, në pjellë e jona, duke konfirmuar se veç me mendim ia dalim të mbiqëndrojmë ndaj kohës. Ndoshta për këtë shkak projektimi që ka mendimi ynë për çdo gjë mund të ngajë i përthyer e jo i qashtë po të shihej së jashtmi.

Kuptohet, që të shikosh së jashtmi mendimin nuk është një abstragim i vogël. Këtu nis monologu që ndodh në prani të gjithçkaje të mundshme, por duke lënë jashtë tij pikërisht gjithçka. Megjithatë argumenti i secilës bisede me veten është çdo grimcë bote që mund të të shohë syri lirish përreth teje. Mendojmë se kjo ndërton thelbin plotësisht lirik të krijimtarisë së Giordanos. Janë të pandashme nga ideja e poezisë së tij imazhi i ujërave, i gjetheve dhe i psalmeve (sikurse e kemi përmendur edhe në shkrime të tjera). Mungojnë tonet e bronzëta epike ose së paku me orientim epik. Ka një tjetër përmasë në mpjeksjen e imazheve. Monologu në nivelin e parë jep përbërësit e ndërtimit të figuracionit dhe përmes tyre ndërtohet abstragimi që nënkupton monologu i thellë, i brendshëm, ai i nivelit të mendimit. Këtë e vërejmë në faktin që janë të gjithëpranishme vizioni i ëndrrës, i mendimeve, ditari, rrëfimi, përfytyrimet dhe ndarjet koho-

Osservando il panorama della letteratura arbëreshe si nota che ormai da tempo vi si può ammirare non solo la letteratura della tradizione, ma anche quella che si scrive oggi. Non è un compito facile riassumere in breve come si è sviluppata questa letteratura, particolarmente nella realtà complessa in diversi piani che ha offerto il XX° secolo. Specialmente il verso poetico degli arbëreshë costituisce allo stesso tempo un mistero e un dono irripetibile per la cultura albanese. Il modo d'essere di questa forma della lingua albanese, il suo difficile viaggio per mettere radici nella poesia di questa minoranza linguistica strappata alla sua fonte 500 anni fa, è senz'altro un supremo atto di sopravvivenza. E' per questo motivo che troviamo che sia più che possibile e altrettanto necessario identificare e studiare a lungo i poeti della seconda metà' del XX° secolo che hanno creato e hanno raffigurato la fisionomia di questa letteratura. Partiremmo non da un nome concreto ma da un fenomeno, il quale naturalmente ci condurrà a un poeta. Il fenomeno di cui vorremmo fare una breve analisi è il monologo come forma d'organizzazione dell'esperienza vissuta e del pensiero in poesia. Questo fenomeno lo abbiamo notato nella poesia di Agostino Giordano. Questo autore ha scritto la sua poesia principalmente fino agli '80 del sec.XX.

Il monologo che vediamo nella sua poesia si svolge su due livelli. Il primo è quello delle sensazioni che esprimono il modo di reagire dei sensi, causati da un denso flusso di elementi esterni. Lo stato che rende possibile tale percezione, e che li prepara per il monologo di secondo livello, è descritto come lo stato di quiete, di sonno e desiderio. Quando questi cessano di esistere appare il silenzio. Invece il monologo del secondo livello è quello del ricordo, quindi il livello dell'esperienza spirituale e mentale. Entrambi i livelli esistono immersi l'uno nell'altro, come fusi sullo sfondo di una generale meditazione sul fenomeno chiamato vita. Il rapporto tra questi livelli sembra un gioco di ore (la poesia "Il gioco delle ore", "Mondo Arbëresh" pagina 36). In essa appare l'ombra dell'uomo, il quale non per caso dà l'impressione del passante destinato a voltolarsi per le strade, in viaggio continuo. Ma quest'ombra non è oggettiva, non appartiene al mondo esterno e che poi il pensiero la prende per elaborarla secondo la sua propria prospettiva. Infatti è lo stesso pensiero che le dà vita. La fonte diventa anche la sua causa di perturbazione, perché nel flusso del pensiero le forme dell'ombra vengono divorate, immerse. Sembra che questo sia un nuovo inizio, ma noi crediamo che sia di più la coscienza della continua ripetizione della convivenza con noi stessi, indipendentemente dal tempo o dalla realtà esterna. Alla fine ciò che rimane nel gioco delle ore è la nostra ombra, confermando che solo tramite il pensiero riusciamo a stare al di sopra del tempo. Forse questa è la causa del fatto che la proiezione delle cose nel nostro pensiero spesso non è chiaro se visto da fuori. Naturalmente non è una piccola astrazione vedere il pensiero da fuori. E' qui che comincia il monologo, che accade in presenza di tutto ma che lascia fuori di sé ogni altra cosa. Però l'argomento di ciascun monologo è ogni briciola di terra che può guardare l'occhio liberamente intorno a sé.

Questo pensiamo che costituisca l'essenza lirica della poesia di Giordano. Sono inseparabili dall'idea della sua poesia l'immagine delle acque, delle foglie e dei salmi (come abbiamo ricordato anche in altri scritti). Mancano i toni bronzati dell'epica o almeno di orientamento epico. C'è un'altra dimensione nell'intreccio delle immagini. Il monologo di primo livello dà le componenti della costruzione della figurazione e, in mezzo a quelle, si costruisce l'astrazione che sottintende il monologo profondo, interno, quello del livello del pensiero. Il monologo di secondo livello si basa sulle visioni, il sogno, il diario, la confessione, e i

Monolog psalmesh

re të imtësishme si orët, nata, mëngjesi, e nesërmja, e sotmja, mbrëmja, çasti e më pak viti. Kjo është poezia e të jetuarit në përmasën e përjetimit e jo në atë të kohës së llogaritshme. Të gjitha ndarjet kohore të sapopërmendura vetëm tendosin, tkurrin ose intensifikojnë dhe veprojnë në ndonjë mënyrë të sofistikuar mbi përvojën e brendshme. Një aktivitet kaq i gjallë i vetes së njeriut gjen së jashtmi ngacmuesit, por pothuajse asnjëherë bashkëbiseduesin. Prandaj shndërrohet në një monolog duke bërë të krijohet nga subjekti lirik vetat e bisedës. Këta janë simbolet.

Diçka tek kjo poezi lëkundet mes të thënës dhe të pashqiptuarës, që ndoshta është e pashqiptueshme. Epiqendra e një gjendjeje të tillë gjendet tek fjalët dhe duket edhe tek poezia me të njëjtin titull e vëllimit "Bota arbëreshe". Një nga trishtimet më të thella është ajo e fjalëve të pathëna. Tani, kohë më vonë ato mbyten në zagushinë e një dhome pleqërie, pa mundur të vdesin e të harrohen por pa arritur as të artikuloreshin në një kohë të dikurshme. Mosthënia lind moslëvizjen. Ajo është tik-taku përcaktues i kësaj gjendjeje të re. Dhe për pasojë koha do të jetë mosveprim. Ky do të matej sikur të ishte kohë. Fjala është bërë tashmë orë. Koha fillon të rrjedhë krejt ndryshe.

Në njërën nga poezitë e Giordanos ndjen hapta aromën e Poradecit:

...E shkoi dhe sonte, / Si dje, / si ngaherë...

Duket sikur reticenca i përmbyll këto fjalë brenda një qarku të pandalur rimishërimesh. Ndërsa Lasgushi shkruante:

Jam sot / Si vjet / Si mot / Si përgjithnjë.

Përjetësia e Giordanos është një përhershmëri e të përditshmes, e pyetjeve të përjetshme, të përsëritura. Qarku i përsëritjes është qarku i një-trajshmërisë dhe një-trajshmëria e rivizuar mbi veten bëhet një hulumtim i vetishëm i paradokseve, i çudive dhe i absurdit të së tërës brenda të cilës edhe njeriu bën pjesë. Ai arrin ta shqyrtojë atë nga lart veçse kur mediton mbi të dhe kur vëren se e sotmja, e djeshmja dhe e përherëshmja nuk kanë kurrfarë kufijsh të ndarë. Mendimi nganjëherë ngjeshet shumë dhe ndërton një lirikë të tejetngarkuar për nga domethënia.

Mes këtyre përjetimeve të shumëfishta e të shtrira shqetësueshëm mbi vetë kohën, dredhon hardhia. Kjo besojmë se është një nga figurat bazë të poezisë së Giordanos. Kjo është një simbol që pak më sipër e quajtmë një nga vetat e bisedës për monologuesin lirik. Ajo të krijon përnjëherë idenë e prejardhjes, vazhdimësisë dhe përcjelljes së esencës së jetës. Kjo është një hardhi që sikurse e kemi përmendur të çon në kohën kur uji bëhet verë dhe kur hardhia ishte qendra e predikimeve dhe shëmbëlltyrave më të bukura të thëna ndonjëherë, tek predikimet e Krishtit. Në njërën nga poezitë e vëllimit "Bota arbëreshe" (*Je si këmbora e vjetër*' fq. 48) të godet ngjasmimi me një fragment shumë të famshëm të Letrës së Palit drejtuar Korintasve në Dhiatën e Re, konkretisht me kapitullin 13, Epërsinë e pashoqe të dashurisë. Një raport i tillë ngjashmërie është çelsi me të cilin realizohet një Rrëfim. Monologu që kurrë nuk kthehet në shpallje rrezikon ta kthejë njeriun në cimbal që tingëllin. Dhe shkruhet kështu Dhiata e vetmisë, e pezmit dhe e privimeve, e cila sigurisht që pavarisist prej nga niset nuk i takon vetëm botës arbëreshe. Kjo është jeta e poezisë. Nganjëherë teksti ka tingujt e thellë të një liturgjie, një meshë e një kungim i çdo dite; një mënyrë për të kujtuar një fakt që sado ta shtysh në qoshet e kujtesës e të mendimit prapë do ngrejë krye, kënga e etërve është një dylufim me kohën. Ky është monologu që u zëshmuu, që u bë dëshmi dhe që u bë rrëfimi më i vjetër dhe i vetmi që nuk ruhet sekret, pasi është e vërteta e ekzistencës së një tërësie njerëzore. Njeriu është dhe mbetet në dylufim me heshtjen dhe me kohën, i tillë edhe sot, si dje, si ngaherë.

segmenti di tempo divisi in ore, notte, mattina, istante, il domani, l'oggi, e un po' meno l'anno. La poesia di Giordano è la poesia del vivere nella dimensione dell'esperienza interna dell'essere umano e non in quella del tempo razionale. Un'attività così intensa non trova comunque qualcuno con cui sviluppare un colloquio. Ed e' per questo motivo che il discorso si trasforma in un monologo, durante il quale il soggetto lirico crea da sé le persone del dialogo, che sono i simboli della poesia.

In questa poesia qualcosa sta sempre tra il detto e il non detto. L'epicentro di una situazione simile si trova nelle parole e si vede anche nella poesia con lo stesso titolo del volume "*Bota Arbëreshe*". Una delle più grandi tristezze mai provate è quella delle parole non dette. Col passare del tempo, esse si rinchiodano in una camera di vecchiaia senza né morire, né vivere e né essere dimenticate. Il tempo non scorre più, e questo suo nuovo modo di essere, il poeta lo esprime con dei versi che ci ricordano il famoso lirico della poesia albanese Lasgush Poradeci:

Ed è passato anche oggi / come ieri / come sempre...

Sembra che la reticenza rinchioda queste parole dentro un circuito irrefrenabile di reincarnazioni. Mentre Lasgushi scriveva:

Sono oggi / come ieri / come l'anno prossimo / come sempre

Ma l'eternità che descrive Giordano è quella del quotidiano, delle domande di sempre e ripetute senza sosta. Il circolo delle ripetizioni si trasforma in un circolo di uniformità. In un tale monologo un simbolo che appare, essendo un compagno di meditazione, è la vite. Subito ti viene in mente l'idea della continuità, della discendenza e dell'essenza della vita.

Nella poesia di Giordano si trovano spesso dei termini che ricordano la Bibbia e a volte anche forti paralleli come quando lui descrive lo stato di tacere quelle cose conosciute. (la poesia "Sei un vecchio sognatore" "Mondo arbëresh", pagina 48). Il parallelismo sta con le parole di S. Paolo nella lettera indirizzata a Corinto (cap 13). Tramite questa somiglianza si nota una Confessione.

Gradualmente la poesia scrive il Testamento della solitudine. E la solitudine si percepisce stando da soli o essendo soli. Questo e' un modo per ricordare un fatto che non si può spingere ai angoli della nostra memoria: che la canzone dei nostri padri e' un duello con il tempo (da una delle poesie di Giordano). Questo e' il monologo a cui viene dato voce e che non rimane più un segreto di confessione perche e' una verità esistenziale. L'uomo e' sempre in un duello con il silenzio e con il tempo, ieri, oggi e per sempre.

(vjen ka faqja 18)

Arbërishtja për Arbëreshët

promuovendo libri o studi eruditi, la lingua va insegnata a scuola e usata in casa.

Cosa fare allora? C'è da vitalizzare i rapporti culturali in Albania, perchè la cultura arbëreshe ne ha bisogno per dilatare il proprio respiro, così come la cultura albanese ha bisogno di scoprire se stessa attraverso la letteratura arbëreshe, antica e contemporanea, come anche attraverso la lingua arbëreshe. L'Arbërishtja conserva la propria identità e continua il proprio sviluppo naturale. Ernest Koliqi, scrittore tra i più grandi del secolo scorso, gli Arbëreshë li andava a trovare d'estate nei loro paesi e a loro riservava corsi di lingua e letteratura albanese. Oggi ci sono molti sportelli linguistici e c'è possibilità di preparare insegnanti dell'Arbërishtja: non mancano né grammatiche arbëreshe né vocabolari arbëreshë; ciononostante l'uso dell'arbëresh va diminuendo, i giovani non l'apprendono e non lo conoscono più come i loro padri o nonni. Questo ci deve far riflettere, perchè l'oasi arbëreshe va riducendosi e il patrimonio di cinque secoli corre seri rischi.

Letërsia arbëreshe krah letërsisë shqipe

prof. dr. Zejnullah Rrahmani
Fakulteti i Filologjisë, Prishtinë (Kosovë)

Letërsia shqipe shfaqet me veprën e parë të saj Mesharin e Gjon Buzukut (1555) ndërsa letërsia arbëreshe disa dekada më vonë, me veprën *Ë mbësue me krishterë* (Dottrina Cristiana). Nuk mund të flas me siguri mbi kohën e vendosjes së parë të arbëreshëve në Itali, mirëpo duke e pasur parasysh kohën e vdekjes së Skënderbeut, koha e shfaqjes së vepër së Matrangës nuk është e largët, dhe fakti që vepra menjëherë filloi t'i shërbente komunitetit arbëresh - dhe siç thotë ai "Gjithsesi është çudi që nëpër rrugët tona tjetër nuk dëgjohej mos zërit të fëmijëve duke recituar doktrinën në gjuhën arbëreshe", - tregon se arbëreshët arritën atje në numër të madh dhe se koha ishte fare pranë shpërnguljes së tyre. Një shfaqje e shkrimit shqip në mënyrë pothuajse paralele në dy pika të ndryshme: në atë që me kusht po e quajmë Shqipëri dhe në viset ku u vendosen arbëreshët në Itali. Tek të parët, do të shfaqet shkrimit shqip edhe emërtimi shqip, shqiptar dhe gjuhë shqipe, tek të dytët do të vazhdojë jetën emërtimi "arbëresh" dhe "arbërisht" për gjuhën. Ndoshta mund të thuhet që ky ngurtësim i dikurshëm në emërtim të popullsisë dhe të gjuhës me qëllim ruajtjen e etnisë e të gjuhës, tashmë e shënjon edhe veçantinë e tyre dhe të gjuhës së tyre. Një proces gradualësisë dhe konservues përkundër procesit të gjuhës shqipe që do të zhvillohet, proces të cilin e përshkruajnë gjuhëtarët por e regjistron domosdo edhe letërsia.

Por, çka kish ndodhur me letërsinë arbëreshe në periudhën pas vepërës *Ë mbësue me krishterë*? Do të kalojnë shekuj derisa të shfaqen sërish vepra të tjera të arbëreshëve. Nikollë Brankati, Nikollë Filja, Nikollë Keta, Dara Plaku etj., do ta bartin letërsinë arbëreshe në shekullin XVIII e këtej. Kjo letërsi gjithashtu e jashtëzakonshme për nga vlerat e saj, do të botohet pak në Itali dhe aspak në Shqipëri. Letërsia arbëreshe do të ndjek natyrshëm procesin e vet të ruajtjes së gjuhës së të parëve dhe në këtë mënyrë do të ecë në drejtim të konservimit të asaj gjuhe, edhe atëherë kur në fillim të periudhës së re letrare, romantizmit, do të shfaqet De Rada me poezinë më reprezentative të letërsisë shqipe të romantizmit në përgjithësi. Vetëm se komunikimi me veprën e tij për shkaqe gjuhësore do të jetë i reduktuar dhe ka vazhduar të ndodhë kjo deri në ditët e sotme. Arsye e parë duhet të quhet gjuha e vepërës poetike, e kuptuar në dimensionin e saj kompleks vetëm nga një numër i paktë njohësish të gjuhës së De Radës. Arsye e dytë quhet fryma e kryeveprave të tij që nuk i ka kënaqur gjithmonë kërkesat luftarake të kritikës etno-marksiste. Poemat e tij me subjekt të fuqishëm dashurie romantike vetëm prekin temën e atdhetarisë brenda konceptit të dilemës së përjetshme romantike midis ndjenjës së dashurisë dhe "nderit", ose midis dashurisë dhe detyrës. Ta përkujtojmë që në këtë aspekt mblidhen në një emërues vepra si Këngët e Milosaos, e De Radës, Kënga e sprasme e Balës e Darës së Ri, kryevepra do të thosha e Skiroit: Mili e Hajdhia, por edhe Mino.

Letërsia arbëreshe ka pasur gjithashtu ngritjet dhe periudhat e heshtjes. Në pesëdhjetë vjetët e fundit, me siguri mund të thuhet, që vitet shtatëdhjeta kanë lënë gjurmë të dukshme në atë krijimtari, të paktën në aspektin e gjuhës që do të inkuadrohet edhe në këtë letërsi. Shkrimit të arberishtes pothuajse me gjuhën standarde shqipe në shumë raste. Pjesë të kësaj letërsie do të botohen në Prishtinë prej viteve kur pjesëmarrës të shumtë të Seminarit për të huajt do të marrin pjesë dhe do të bëjnë të njohur një realitet të ri të arbëreshëve që përballen me jetën brenda një Italie të zhvilluar e moderne. Arbëreshët që ruajnë përhapin një madhësi të mrekullueshme të së kaluarës, një frymë ta quaj aristokratë të paraardhësve që janë në nivel të Evropës dhe të tashmes ku rreziku për asimilimin dhe shkrimin e kësaj pjesë të etnisë është i përditshëm.

(ec te faqja 25)

(vjen ka faqja 20)

Dhimitër Kamarda i shkruan De Radës

na e thotë hapët kur shkruan se "procuo di avere tutte possibilmente le produzioni albanesi", e mësimë dëshiron të ketë gjithë librat që shkruan De Rada, pse kish shumë risipet për këtë poet e patriot të madh, e librat e tij i konsideronij si me shumë vlerë për gjuhën, për literaturën e për gjithë komunitetin arbëreshë, që kish bëzëz të konfirmoj identitetin e tij, si edhe për të tërë Shqipërinë që kish të shkundij dominin turk dhe kish të buthtonij Grekëvet e Sllavëvet se Shqipëria ish një nacionë me një kulturë e një gjuhë të vjetër që edhe nd'atë mot ish prodhutive, e gjallë e shumë e bëgatë. Nga të shkëmbyerit e literavet ndër intelektualëvet arbëreshë mund të bëhen dy konsideraciuna: 1) ish i madh interesi që intelektualët kishin për librat që shkruheshin për literaturën, për gjuhën e për kulturën arbëreshe; vjen me thënë se kishin koshenxien se ture konsoliduar kulturën, literaturën dhe gjuhën arbëreshe, fortërohej identiteti i komunitetit arbëresh si edhe identiteti i nacionës shqiptare;

2) ish e madhe edhe dëshira që intelektualët kishin për një sodalix që mblidhnij gjithë skritorët e personalitetet që mirreshin me kulturën arbëreshe, sa të shërbenjin. Letërsia arbëreshe ka pasur gjithashtu ngritjet dhe periudhat e heshtjes. Në pesëdhjetë vjetët e fundit, me siguri mund të thuhet, që vitet shtatëdhjeta kanë lënë gjurmë të dukshme në atë krijimtari, të paktën në aspektin e gjuhës që do të inkuadrohet edhe në këtë letërsi. Shkrimit të arberishtes pothuajse me gjuhën standarde shqipe në shumë raste. Pjesë të kësaj letërsie do të botohen në Prishtinë prej viteve kur pjesëmarrës të shumtë të Seminarit për të huajt do të marrin pjesë dhe do të bëjnë të njohur një realitet të ri të arbëreshëve që përballen me jetën brenda një Italie të zhvilluar e moderne. Arbëreshët që ruajnë përhapin një madhësi të mrekullueshme të së kaluarës, një frymë ta quaj aristokratë të paraardhësve që janë në nivel të Evropës dhe të tashmes ku rreziku për asimilimin dhe shkrimin e kësaj pjesë të etnisë është i përditshëm. mirë Letërsia arbëreshe ka pasur gjithashtu ngritjet dhe periudhat e heshtjes. Në pesëdhjetë vjetët e fundit, me siguri mund të thuhet, që vitet shtatëdhjeta kanë lënë gjurmë të dukshme në atë krijimtari, të paktën në aspektin e gjuhës që do të inkuadrohet edhe në këtë letërsi. Shkrimit të arberishtes pothuajse me gjuhën standarde shqipe në shumë raste. Pjesë të kësaj letërsie do të botohen në Prishtinë prej viteve kur pjesëmarrës të shumtë të Seminarit për të huajt do të marrin pjesë dhe do të bëjnë të njohur një realitet të ri të arbëreshëve që përballen me jetën brenda një Italie të zhvilluar e moderne. Arbëreshët që ruajnë përhapin një madhësi të mrekullueshme të së kaluarës, një frymë ta quaj aristokratë të paraardhësve që janë në nivel të Evropës dhe të tashmes ku rreziku për asimilimin dhe shkrimin e kësaj pjesë të etnisë është i përditshëm. bashkë për të mirën e kulturës arbëreshe, si edhe sa të bashkonjin gjithë arbëreshët si shkruan Kamarda: "per una reale unione fra gli albanesi".

Fjalët e Kamardës, si dje, thom se mësimë sot, janë shumë atuale dhe mund t'i konsiderarim si një mesaxh i fortë për gjithë intelektualët arbëreshë.

Shkulqia

(transkriptoi) Agostino Giordano

ka Purçilli (Cs)

Shkulqia - çë qe botuar, po jo plotësisht e jo sipas redaktimit të saktë të autorit, mbi revistën "Zëri i Arbëreshëvev" (nrr.4/1972, 5/1973, nr.8/1974-1975) - gjëndet mbrënda një fletorje, cm.13,5x21,5 cm., çë numëron 170 faqe, të panomruara ka autori, e çë përmban këto vepra ose poezi: *Zakonet e Frasnitës*, faqe 1-90, e filluar ndër 26-8-1894 dhe e mbaruar ndër 23-10-1894, tercina me rimë ABA, 1976 vargje njëmbëdhjetë rrokjesh (te ky numërim mbami jashtë vargjet ku Bilota citon vjershe popullore të Frasnitës); *Shkulqia, Seconda parte del matrimonio, Il matrimonio*, njeri pas jetrit, faqe 91-160, e filluar ndër 26-5-'94 dhe e mbaruar ndër 27-6-'94), 127 strofa gjashtëvargjesh me rimë ABABCC, strofa ..., 762 vargje njëmbëdhjetë rrokjesh; (te ky numërim mbami jashtë vargjet ku Bilota citon vjershe popullore të Frasnitës); *Të lerit*, faqe 161-166, e filluar ndër 1-7-1894 dhe e mbaruar ndër 2/7/1894, 21 strofa gjashtëvargjesh me rimë ABABCC, 126 vargje njëmbëdhjetë rrokjesh; *Njeter short pakzimi ndër t'Arbresht*, faqe 166, sonet, me datë 3-7-1894, rimë ABBA ABBA CDC DCD; *Pse kuku trëmben qët e bën e nguren?*, faqe 167-8, 8 strofa katërvargjesh, rimë ABAB, vargje 32 njëmbëdhjetë rrokjesh; *Pse kūr bën vap dhent rrangarjen ka mbëzimet?*, faqe 168-9, 7 strofa katërvargjesh, rimë ABAB, vargje 28 njëmbëdhjetë rrokjesh, me datë 18-5-1895.

1.
Lulëza trimëris sa është mbë të,
ka Malli e Hjezit gjith e zburruer,
hilqet ka vasha, kë me zëmer do,
se t'piksenj me të t'miren e shërtuer:
hilqet të marr vashen, tek të sheh
mallin, kë mbë zëmer ndien e njeh.
2.
Me të përpara ndër trū s'zë rrëçët
dit e nat e lusen mbān e e kndon.
E do t'e kët, të jët i tēr ndë jet;
e do, se sheh te ajo çë do shërton
së miri gjella; e do, se i duket hjë
e piksurez me drit, mall e harë.
3.
Rrot shpizës sāj, çë ndjet një vashez ari,
një vashez çë së gjëndet gjek më māj
si ajō; shihet si fjtur ka hilnari
të vër ngahër t'e prënj me hjën e sāj
çë naten s'bëne i qlon e del e e kndon
e dorez lule e t'mira ç'kā i dirgon.
4.
Si trimi vren e xë se vasha e do
me zëmer si t'e do ai, kallzon
gjithve mallin fort, çë ndien për të
e ashtu çë t'e marr së bën e i pshton.
Kallzon gjithve kët mall se t'bë t'e xën
e prindt e tij e t'vashez të dīr çë thōn.
5.
Sa nënga ai prëçmon, se i rā ndër vesh
kush ē vasha, kë do e ata të duen,

po të ndreqen mbi palen, jeta shesh
gjith duket trimit: ndihet gjith i gzuem
e bën faqe e s'ëmes më pār thot
kush ē vasha ç'i vū ndër trū Inzot.

6.
I truhet shum të jatin se të shīnj
të dēt të bē t'e marr, se atē do;
e të dirgojen t'e lipjen, se të hīnj
dhënderr sā më njize tek ajo.
I thot "Me të më bēni të fanmīr,
e, për sā rronj, ju e kam u mbē t'mīr".

7.
E jēma, ndēse vasha t'i pëlqen,
se ndihet pre së miri e s'që zēn fīll
pre s'ligu māj, me sī të but të vren
të birin e t'i thot: "Sonde o menat
u fjas për kēt shurbes bashk me tēt at.
8.
Ti kishe çë mund rrjje më gjē mot,
të prëshse trim si jō i pa-ngatrrier.
Të ndjet se, pra ç'martohe, jeta ē pjot
vërtet me t'mirat dashur? I gënjier
të gjēnde prë një pjes, si gjith u gjëndtim
se, me sā mir të streksjem, nëng u ndëndtim.

9.
Kush ja 'rtrēn, bīr, ksāj jet, ç'ē gjith e rrem!..."
"Mēm, kēshtu mos më fōl ndē më do mīr.
U dua të marr at vash mē k' pres të jēm
ndē jet i mē kutjendi e i mē fanmīr.
Me taten fol e ule, të më dēt

kutjend me atē vash ç'ē m'kā gjith hjēt".

10.
"Bīr, u t'i fjas t'it eti e sā më mundenj
u bēnj t'e ulenj se të dēt t'martōnj
me vashen kë ti do, kë s'und të t'shkundenj
ka zēmra e ka trūt ku t'u vū zōnj.
Ē e mīr si thua vërtet e bil hadhjari
e të ka hjē t'e marsh ti, bīr bulari".

11.
Kūr trimi gjegj kto fjal, u llambardhos;
u ndie të ngit parrajnsin me di duer:
me mall e me harē ka e jēma u stros
e i puthi të di duert me unaza mbjuer.
I tha:"Tij mēm, përse më do t'fanmīr,
si sīt e vet-hën tīme kam dua mir.

12.
U vashēs sonde vete e ja këndonj
se ti më do t'e marr e se t'pīlqen.
Një dorez trendafilje m'i dirgonj
menat me gruen, çë neve na shurben.
E kā t'i qellenj edhe t'faljet tua..."
"U, pār të fjas me t'tat, zēn fīll së dua.

13.
Pra ç'fjas me të, e ulet si u t'dēt,
fjē, bīr, se proksonit mbjatu dirgonj.
U dua të t'shoh kutjend me kë t'kā hjēt
e mallit zëmres tēnde. Dua të t'bēnj
kutjend sa më më mua të rrī. Mē nget,
mos fare të helmonj tij, bīr të vet'(...)

(vjen nga faqja 24)

Letërsia arbëreshe krah letërsisë shqipe

La letteratura albanese inizia con il *Messale* di Gjon Buzuku (1555) - scrive Zejnullah Rrahmani - mentre la letteratura arbëreshe inizia, alcuni decenni più tardi, con *Dottrina Cristiana*, del Camarda. Comparsa dello scritto albanese quasi parallela in due punti diversi: in Albania e nelle zone dove si sistemarono gli Arbëreshë in Italia. In Albania, accanto allo scritto albanese comparirà anche la denominazione shqip/shqiptar/gjuhë shqipe, mentre in Italia continuerà la denominazione arbëresh/ arbërisht. Questo significa, da parte arbëreshe, voler mantenere etnia e lingua. Processo conservatore, quello arbëresh, contrariamente al processo della lingua albanese, che si svilupperà, secondo quanto descritto dai linguisti e registrato dalla letteratura. Dopo *Dottrina Cristiana*, la letteratura arbëreshe deve attendere molto prima che vedano la luce altre opere di arbëreshë: Brancato, Figlia, Chetta, Dara il vecchio ... Questa letteratura arbëreshe, - straordinaria per il suo valore, poco pubblicata in Italia e per niente in Albania - proseguirà nella conservazione della lingua, anche quando, all'inizio del nuovo periodo letterario del romanticismo, De Rada scriverà la poesia più rappresentativa della letteratura albanese romantica. Solo che la comunicazione con la sua opera, per motivi linguistici, sarà ridotta e così è continuata fino ai giorni nostri. La letteratura arbëreshe ha avuto periodi di crescita e periodi di silenzio. Negli ultimi 50 anni, gli anni '70 hanno lasciato tracce visibili, perlomeno sotto l'aspetto linguistico: in molti casi si è preferito la lingua standard alla lingua arbëreshe.

Dialektet e shqipes dhe gjuha standarde

Mercoledì 13 maggio 2009, presso il Dipartimento di Studi dell'Europa Orientale dell'Università di Napoli "L'Orientale", la Prof.ssa Ledi Shamku-Shkreli, dell'Istituto di Linguistica e Letteratura di Tirana, ha tenuto una conferenza dal titolo "Dialekti albanesi e lingua standard", nell'ambito del ciclo di lezioni per il dottorato di ricerca in Culture dell'Europa orientale.

Nella presentazione, il Prof. Italo Costante Fortino, commentando il titolo del libro della relatrice, "Standard dhe neostandard" (Tirana, Botime Çabej 2007), ha sottolineato la novità del termine "neostandard", che sottende il superamento della staticità di cui si avvaleva generalmente il concetto di "standard".

Il rapporto dialetti albanesi e lingua standard è uno degli argomenti più importanti del dibattito culturale in Albania negli ultimi 20 anni. La lingua standard, in vigore dal 1952, e riaffermata con rigore dal Kongresi i Drejtshkrimit (Congresso sull'ortografia) del 1972, aveva lasciato irrisolti una serie di problemi.

A. Metodologji e standardizim

Zgjedhja e dialektit toskë, si bazë dialektologjike e gjuhës standarde që po krijohet, e përbysit kryekëput vendimin e Komisionit Letrare të Shkodrës, që kishte përzgjedhur në vitet 1916-17, si bazë dialektologjike të gjuhës zyrtare të shtetit të sapoformuar shqiptar, variantin gjuhësor të Elbasanit, duke synuar kështu një prurje të natyrshme të elementeve nga të dy kryedialektet e shqipes, gegë e toskë.

Më anë tjetër vendimi i Konferencës gjuhësore të 1952 nuk u mbështet në asnjë studim shkencor paraprak të usus-it, si në gjuhën e shkruar ashtu në gjuhën e folur. Kjo dobësi në impostimin e problemit pati pasoja të ndryshme; ndër të cilat më e rënda që lënia mënjane e pasurisë së varietetit dialektor gegë, me të cilin ishte krijuar një pjesë e rëndësishme e pasurisë letrare të trashëguar. Kështu që standardi i ri mund të merrte frymë vetëm me një mushkëri, atë toskë.

Duke analizuar punën e bërë në Shqipëri në vitet që pasuan Luftën e Dytë botërore, prof. Shamku-Shkreli vuri në dukje se difektet në kodin standard u krijuan pikërisht nga përbysja e mënyrës së procedimit për përcaktimin e kodit. Si rregull, për të përcaktuar normën standarde, fillimisht grumbullohen dhe studiohen fenomenet gjuhësore, pastaj përzgjidhet elementi i normuar.

Në vitin 1952, kur përmes akteve zyrtare u ngrit dialekti toskë në nivelin e gjuhës zyrtare ky studim ende nuk ishte bërë. Në mbështetje të tezës së saj prof. Shamku-Shkreli solli në vëmendje të auditorit se asokohe nuk qe krijuar ende pranë Institutit të Shkencave sektori i arkivit të leksikut shqip, gjë që ndodhi vetëm 1 vit pas botimit të fjalorit të gjuhës shqipe më 1954.

